REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

SEKRETARI I KËSHILLIT

Datë 14.08.2026

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 14.08.2026, në konsultimin Publik, në ambjentet e NJ.A Vreshtas Projektligji: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë.
ora 13:00.

Të pranishëm:Këshilltar:z.Petrit Kupe; Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi;Sekretari i Këshillit:Gertjan Gjiriti; Këshiltarët z.Dritan Çami; znj.Klea Baçi; Adminitratori e NJ.A Vreshtas z.Qezar Bezati; Kryetarë fshatrash; banorë të NJ.A Vreshtas sipas listës bashkangjitur.

Këshilltar:z.Petrit Kupe: Hapim këtë takim të rëndësishëm në kuadër të platformës "Reforma Administrative Territoriale". Këshilli i Bashkisë Maliq organizon këtë dëgjesë me komunitetin. Është një periudhë 60-ditore gjatë të cilës do të merren vendime nga komuniteti për reformën e territoriale, ashtu siç jeni në djnei Në këtë projekt të reformës territorial parashikohet bashkimi i Bashkisë Maliq me qytetin e Korçës. Në zbatim të ligjit, neni 89 dhe 90 të Ligjit nr. 139/2015 për Qeverisje Vendore, kërkohet nga kryetari i bashkisë të paraqesë mendimin e tij zyrtar të argumentuar mbi propozimin bashkiak. Këshilli Bashkiak të shqyrtojë propozimin në mbledhje dhe të miratojë mendimin e tij zyrtar, duke pasqyruar në aktin përkatës qëndrimet kundër ose alternativës, nëse ka. Bashkia organizon informimin, konsultimin, ashtu siç është edhe ky takim i sotshëm, të dëgjesave publike në të gjitha njësitë administrative. Ne jemi dy përfaqësues të Këshillit të Bashkisë: zoti Fazlii, nënkryetar i Këshillit të Bashkisë; unë jam këshilltar i Komisionit të Ligjeve dhe Kryetar i Komisionit të Financës. Ashtu siç e thashë në fillim, gjithsecili është i lirshëm të shprehë mendimet, anët pozitive apo anët negative që mendohet se çfarë mund të krijojë ky bashkim i propozuar. Ndaj, ne jemi këtu për të dëgjuar, nuk jemi për t'u prononcuar, as unë as asnjëri. Ne do të dëgjojmë mendimet tuaja, do t'i pasqyrojmë në procesverbale përkatëse, do t'i pasqyrojmë në mbledhjen e Këshillit, dhe aty do të japim mendimin përfundimtar për këtë propozim të reformës administrative. Kështu që, jeni të lutur të merrni fjalën, por me radhë, që të dëgjohen mendimet tuaja që keni për këtë propozim të ardhur nga parlamenti. Faleminderit.

Banor i NJ.A Vreshtas: Nuk jam dakord me të, se ne mosha jonë, me fuqinë që kemi, nuk mund të shkojmë deri në MaliQ, qoftë të shkojmë në Korçë. Dhe ato duhet të parë një çik më shumë në këto punë. Këtu tashi, njerëzit janë më shumë pleq se sa janë të rinj. Janë të vetmuar. Të tërë të vetmuar. Ku do shkojmë për një kartë në Korçë? Ne s'po çajmë dot këtej që jemi më afër, jo të shkojmë deri andej. Mendimi im është që bashkia është shumë mirë këtu ku është, s'ka pse të largohemi diku tjetër. Këtë kisha mendim unë.

Banor i NJ.A Vreshtas: Bashkimi i Maliqit dhe Korçës, është e gabuar? Sepse, vetëm duke qenë larg, çdo shtëpi i largohet pjesës së banorëve të fshatit ose të fshatrave periferike. Pastaj, Bashkia e Maliq ka edhe historinë e vet: kemi qendër, bëhet Maliqi, kemi Bashkinë e Maliq, ka një numër të madh banorësh, ka një sipërfaqe të konsiderueshme, ka fituar investime. .. nuk e di, nuk ka bërë më të mirën e mundshme, por ka fituar investime dhe është e gabuar. Për mua është shumë e gabuar. Nuk e di për banorët e tjerë, por mendoj se, duke qenë më larg, sidomos në zonat periferike, do ta kemi më të vështirë të përfitojmë ndonjë shërbim nga Bashkia e Maliqit. Nga Bashkia e Maliqit-Korçë, kur të bëhen njëherë të dyja. Pastaj edhe nuk do të besoj se do jemi po aq të përfaqësuar sa ndjehemi të përfaqësuar tani.

Banor i NJ.A Vreshtas: Çfarë të themi, çfarë të lejmë? Kjo është arsyeja pse ky vendim që është marrë tani për të marrë vendime në një bashki tjetër, për zhvillimet tona. Bashkia jonë është një bashki shembullore, një bashki me fuqi të madhe popullsie të tërë. Dhe ku është arsyeja që bashkia tonë shkon në Korçë? Nuk e di, ky është pyetja. Tani, ne duhet të kemi mendimin tonë. Në asnjë mënyrë nuk duam që bashkia e Maliqit të shkrihet. Bashkia e Maliqit është një bashki shembullore, nga të gjitha komunat e tëra. Tani, për një kafshë, siç tha zonja para se hoqëm, i lumtë. Për një kartë, vemë në Korçë 35 km, 35-70 km. S'mbarojmë dot punën atje, por s'mbarojmë dot punën. Do bëjmë ditën tjetër. Çdo gjë, problemin e kanë zgjidhur prej këtu në Maliq. Janë zgjidhur të tëra problemet. Këtu ku është arsyeja? Tani, ai nuk do. Ai ka marrë vendimin, se do ta dijë të tërën. E ka marrë vendimin, vulën e ka vënë ai. Ne nuk duam të protestojmë që bashkia të mbetet Maliqi.

Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi: Për veten tuaj, jo për askënd, që bashkia të qëndrojë dhe a ka mundësi të shtohet, jo të pakësohet. Po keni dëgjuar që do merren po. Kështu që jo— po jani, po ta ketë— neve do ta sugjerojmë të gjithë mendimin tuaj, se ne po i bëjmë të gjitha sa të diheshim edhe në po janë, dhe do t'i sugjerojmë në këshillin, bashkë me zotërinjtë shqiptarë dhe Danin dhe Drejtin. Do shkojmë aty, do ta bëjmë dokumentin, mendimet tuaja të jeni të sigurt që ne do t'i transmetojmë sipas ligjit dhe rregullave aty ku duhet. Dhe më bëhet qejfi që ju jeni tërë në unison që bashkia, sepse është shërbimi tuaj. Nuk është shërbim.Jam plotësisht dakord, ju dëgjova, dhe ju falënderoj të gjithëve, një për një, që jeni këtu dhe ata që na dëgjojnë. Kështu që bashkia duhet t'u përkasë qytetarëve, askujt tjetër. Dhe në qoftë se ne realizojmë këtë, e kemi bërë detyrën. Në qoftë se neve shkojmë pastaj kur thonë "zonja më përmendën atë" e në Korçë, nuk jemi mirë kështu. Kështu mendoj unë. Unë e dhashë këtë mendim, as politikisht, asgjë. Jam qytetar, jam këshilltar, jam bashkë me ju, dhe do të jem në krah tuaj. Faleminderit.

Kryetar i fshatit Vreshtas NJ.A Vreshtas z Andrea Baxhelli: Jam kundra bashkmit të bashkisë Mlaiq me bashkinë Korçë.

Këshilltar:z.Petrit Kupe: Do ketë parasysh edhe sugjerimet tuaja, edhe vendimin e këshillit. Do të shohim si do ecë. Unë, për mos u vonuar, ju falënderoj për pjesëmarrjen, megjithëse edhe pak drekë. Ju uroj shëndet dhe suksese në punën tuaj. Faleminderit.Kemi diçka tjetër? Ditë mbarë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbajtës Protokolli!

Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

SEKRETARI I KËSHILLIT

Datë 17.08.2026

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 17.08.2026, në konsultimin Publik, në ambjentet e NJ.A Moglicë Projektligji: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë.
ora 11:00.

Të pranishëm:Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari; Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi;Sekretari i Këshillit:Gertjan Gjiriti; Administratori i NJ.A Moglicë z.Fetah Hoxha ; Kryetarë fshatrash; banorë të NJ.A Mogilcë; sipas listës bashkangjitur.

Administratori e NJ.A Moglicë z.Fetah Hoxha:Këshilli i bashkisë ka dalë në çdo njësi që po bën takime: është nënkryetar i këshillit, kryetar i këshillit, sekretar i këshillit. Besoj se e njihni secilin.Dhe do diskutojmë, Nildi do na i sqarojë, do diskutojmë rreth të mirave dhe të këqijave që ka ky projekt, sidomos për bashkimin e bashkisë tonë me Korçën. Ju faleminderit për pjesëmarrjen, se të gjithë jeni në kulimin e punës, plus që filloi edhe keq, është edhe festa e Tomorrit, edhe ndaj pjesëmarrja mbase na çalon pak. Goxha të rinj kanë ikur andej, por prapë pjesëmarrja u rikënaqën. Kam njoftuar kryepleqet e fshatrave të të gjithë njësisë, me përjashtim të një Kryetari, vetëm ajo na mungon, të gjithë i kam këtu. Që të njihen edhe me problematikat, mos thonë nesër pastaj: "Jo, e dija unë", por s'e dija unë. Jo më lajmëruat mua. Edhe kur të vini për fshatrat, ja bëni të qartë çfarë do dalë në këtë takim.Që është nga institucionet më të shpërndara, edhe më e largëta nga qendra e bashkisë. Neve kemi 19 fshatra që 2-3 fshatra i kemi pa rrugët, dhe sot që neve shërbimi jo të na largohet, po të na hiqet fare, për mendimin tim.Edhe të themi se nuk është bërë punë nga njësia që— nga bashkia që kemi patrulluar maliq. Kemi bërë disa punë, po ka punë për të bërë prapë. Po të vesh në Korçe, të marrësh ti të thurësh varrezat e Kodrasit, e Tosojës, e të Dushari, edhe të marrësh fadromat ti që andej, të punosh, as do ta fshijmë. Se neve ja ku e kemi Lekasin, që është nga bashkia e Korçës, ka lekë, edhe ata thonë: "Ore, lumi ju që keni Gëzimin.

Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari: Faleminderit që u mblodhët.Ky është një takim konsultimi, të themi, ose dëgjesë publike që e quajmë ne në gjuhën ligjore, dhe organizohet nga Këshilli Bashkiak në bashkëpunim me bashkinë, me ekzekutivin, në bashkëpunim me Fetahun këtu, dhe ka për qëllim diskutimin lidhur me reformën administrative territoriale që po zbatohet në Republikën e Shqipërisë. Besoj jeni informuar: u krijua një komision i posaçëm nga parlamenti, bipartizan, nga të gjitha partitë, për të rishikuar ndarjen administrative territoriale në Shqipëri. Komisioni ka 6-7 muaj, në mos gaboj, i cili po punon dhe arriti në një përfundim. Në një përfundim, nxorën një raport-propozim dhe e kanë depozituar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për shqyrtim, për miratim ose mosmiratim. Tani, propozimi që ka çuar komisioni i posaçëm është i tillë që, nga 61 bashki që janë sot në Republikën e Shqipërisë, komisioni propozon

të ngelen 46. 15 bashki aktuale do të bashkohen me bashki të tjera. Dhe konkretisht, komisioni propozon që bashkia jonë e Maliqit të bashkohet me Korçën. Duke u depozituar në Kuvend ky projekt-propozim, Kuvendi i drejtohet Këshillit Bashkiak të Maliqit, se është procedurë ligjore, është detyrim ligjor, që Këshilli Bashkiak i Maliqit të shprehet në lidhje me këtë gjë. Domethënë, të shprehet, a është dakord apo s'është dakord. Tani, Këshilli, nga ana e vete, ka detyrim ligjor që të konsultohet me banorët, me qytetarët, dhe për këtë arsye jemi sot këtu në Moglic. Këshilli do të konsultohet me qytetarët. Ne jemi duke zhvilluar takime dhe në një mbledhje të posaçme, të cilën e kemi paracaktuar, është data 20. Këshilli do të shprehet nëse është dakord apo s'është dakord, dhe do t'ia përcjellë përgjigjen parlamentit, Kuvendit të Shqipërisë, ku t'i thotë që ne jemi ose s'jemi dakord. Dhe përpara se ne të zhvillojmë mbledhjen, duhet të marrim mendimin e qytetarëve. Tani, kthehem prapë tek çështja. Çështja është që ne propozohet të bashkohemi me Korçën. Tani, kjo është pyetja: a jemi ne dakord të bashkohemi me Korçën? Nga ana tjetër, vlen të theksohet sepse është mirë a është keq?Më duhet, duhet të ndalem pak edhe tek çfarë është mirë apo çfarë është keq, pa dashur të ndikoj mendimin. Bashkimi me Korçën krijon një bashki më të madhe, që do të thotë krijon më shumë, ëh, fuqi financiare. Njësitë administrative, përfshi edhe maliqin, do të kenë fonde të dedikuara që s'e kanë pasur deri tani. Pritet që të bëhen ndryshime ligjore te ligji organik, që të kenë fonde të dedikuara. Këtë ma kanë thënë, nuk e di.

Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi: Faleminderit! Ju duhet të luftoni për të drejtat tuaja, pjesë e cili është nga ju është këtu, sepse ne së bashku unë sot kam ardhur këtu me kënaqësinë më të madhe dhe për vështirësitë që ka kjo zonë dhe vështirësitë që unë ndjej. Dua t'ju falënderoj një për një juve që këtu edhe ata që na dëgjojnë dhe nuk janë sot pjesëmarrës këtu, dhe koordinatorin e komunës për takimin që na ofrohen me ditë për ditë. Kjo është një çështje shumë madhore. Pyetjet që u bënë në dy bashkëshortat e mi, në dy njerëzit e mi që janë këtu, qoftë Llazi qoftë Barimi, janë me vend pyetjet. Po këtu është më thellë akoma. Unë do t'u flas si djali i këtij fshati dhe sot duhesha me patjetër që të vija këtu, se komuna apo populli i kësaj zone, për aq sa janë, e kanë më problematikë në qoftë se neve bashkojmë me poshtë. Do të thotë, siç shpjegoi kryetari, Ornildi, që do ketë shumë investime, do ketë shumë gjëra të mira. Për mua, dhe ma mbani mend, vëlla, nuk ka asnjë gjë të mirë. Është e kundërta e ligjshme për mua. Pavarësisht se është një projekt, e dalim tek pyetja që thonë: a është e vërtetë apo nuk është e vërtetë. Populli i zonës time, tuaja, bashkë e gjithë Shqipërisë edhe Maliqit, duhet ta mbrojë atë institucion që kanë. Për shumë arsye. Institucioni i bashkisë, mendoj unë, nuk është institucion "po prish komunale ose prish kombinate", që edhe atë e diskutuam rrugës, se s'duhet të ishte prishur. Por është një institucion që u jep shërbim qytetarëve në çdo sekondë. Sepse i kërkon rrugën këtij zotërisë këtu, sot nesër do jetë tjetër, s'ka rëndësi emrash këtu, i kërkon dritën, i kërkon arsimin për ato dy fëmijë që kanë, se s'ka mundësi ndaj të dalin në Maliq apo s'ka mundësi të shkojnë në Tiranë. Duhet të jetë këtu. Ti je i detyruar, kushtetuta e Shqipërisë hapet ligjit themeltar, është drejtat e njeriut. Atëherë, neve në këtë jemi në shkelje të ligjit themel, për veten time. Dhe unë çfarë kërkoj këtu? Unë kam ardhur sot këtu si një qytetar, si këshilltar, ta lë edhe si nënkryetar i këshillit, ta lë edhe si djali i fshatit tuaj, edhe derisa kam punuar këtu kam qenë edhe mësues, kam punuar edhe përgjegjës, i di këta dhe i njoh dhe ju falënderoj. Por duhet ta thashë këtë: këtu po prishet mekanizmi i votës. Sepse dy zotëria këtu që unë e kam mik edhe ju e keni administrator dhe kam njohur këtë respekt që bëri atë rrugë me iniciativën të tij dhe të këshillit, të këtij djali këtu, dhe bashkë ne me këshillin kemi hartuar një fond që është pruama sa bëhet. A e kemi bërë 100% mirë? Nuk e kemi bërë. A do ta bëjmë? Do mundohemi ta bëjmë akoma më shumë. Po po shkojmë në Korçë neve, si do bëhet kjo punë? Nuk

bëhet. Pyetja është e thjeshtë. Tani çfarë duhet të themi në këtë histori? Prandaj, vëllezërit e mi këtu, duhet vrarë mendja të mos kemi gjëra më të mëdha se sot është ky apo nesër është ai. Po të më pyesësh mua, unë jam në opozitë me Gëzim Topçiun, po të iki bashkia që aty, për mua Gëzimi ka punuar më mirë nga të gjithë këta që edhe Filo që unë kam kontakte takohem. Nuk e them këtë as për ta luvduar as Gëzimin se do jetë këta nuk do jetë Maliqi do jetë të ikë. Kjo nuk është shumë e rëndësishme. Por e rëndësishme është që ne pyetja shtrohet: i afrohemi shërbimit apo i largohemi? Si do vijë se fshati tuaj është më i largët dhe fshati tim Dushar është akoma më larg. Dhe tjetri tjetri këtu do vejë në Korçë, ne e njohim mirë se jemi këtu. Rruga vështirësohet, vështirësitë vështirësohen, administratë nuk do kesh. Tërë ato ambientet të biznesit do humbasin në Maliq dhe do kthehet si Moglica. Më falni se po shkruaj, se do kthehet si këto që s'ka kur kemi ne një fat të keq, mos fat të keq, dhe do përfundojnë keq. Po e rëndësishme është që ne nuk do të marrim shërbim. Nuk do marrim shërbim. Do të thoshte: çfarë thua kështu se shteti do funksionojë? Jo. Është prishur mekanizmi i votës. Po ta them edhe njëherë. Sepse po e bëri kështu ai, do vendosi këtë në bashkësi Gëzim apo Nildi apo një tjetër. Do emërohet, nuk do zgjidhet. Dhe këtu kemi një gjë, kuptoheni thellë punën. Tjetër emërimi dhe tjetër zgjedhje. Se pastaj e bën kështu me diktat dhe ato 40 bashki do t'i komandojë një dorë e vetme. Kryeministri që është sot apo nesër kush do të jetë. Prandaj do të jetë më mirë bashkia. Unë do t'ju jap një shembull konkret te Maliqi dhe ju të janë të vjetër këtu burrat edhe jeni të respektuar që moti kur ndaheshim në shtëpi ishin pesë gjashtë djem edhe thoshin prindër t'i ndajmë që të marrim tre televizora të bëjë ky me vete ky me vete. Ne tani po e bashkojmë tre televizora t'i shkrijmë kur do ketë më të mirë që të jemi sa më shumë dhe projekti mendoj unë edhe dua që juve të thoni mendimet e veta projekti që është bërë që të bëjnë 41 bashki të shpërishin 15 bashki midis të tjerë dhe Maliqit. Po të shikojmë bashkinë e Maliqit vëllezër të mi është një bashki me 81 fshatra mos gaboj 81 po 81 fshatra është një bashki me potencial në shkallë vendi për sipërfaqen për të gjitha gjërat e treta këta me internet të lartë do të na thjeshtojnë për tre vjet mbas këtyre zgjedhjeve po u garantoj që do thonë shkoni në Elbasan siç kanë ikur gjykatat në Tiranë gjykata administrative siç kanë ikur institucionet e arsimit siç ka ikur bordi i kullimit po kështu do shkoj bashkia do të iki dhe zjarrfikësja janë gjashtë do të jetë një ose s'do jetë fare e do presë të vijë nga X-i do të iki policia e do të jetë mirë dy tre policë e kështu me radhë do të iki dhe shkolla do të iki dhe ajo lokalit do të iki dhe ajo godina e bukur që është bërë me investimet dhe me djersën tuaj time në të gjithë komunitetit do të iki dhe i pallati i kulturës sepse do të mbetet keq e më keq dhe çfarë fitojmë neve këtu tashti prandaj nganjëherë edhe politikat duhet t'i kundërshtojmë si qytetarë dhe unë kam kështu një mendim dhe mbajeni mend hajde të shkojmë në referendum si të gjithë Maliqit të bëjmë referendum si të thotë populli se fundi i fundit ai çobani kushdo që është Edi Rama kryeministër po kush e ka zgjedhur ky populli e keni zgjedhur ju dhe unë isha bir për vendin me nja tre vota këtu si opozitë turp i botës jo se si isha unë as nuk e kam problemin për veten time unë jam në këtë moshë mot do dal në pension dy fëmijë t'i kam jashtë shtetit po duhet menduar ky mesi që është këtu ai tjetri që është dhe aqupke e vogël duhet menduar që çfarë i lëmë të ardhmes çfarë u lëmë brezave kjo është shumë e rëndësishme prandaj ju them kështu unë dal me këtë konkluzion reforma territoriale të bëhet se jam kundra po jo me një terren të lapsit dëgjesa se kush thotë dëgjesa duhet pyetur populli dhe populli të vendosi do thoshte i kanë bërë plan po po e kanë bërë ashtu ne do rezistojmë fort me protesta me të gjitha mjetet demokratike dhe s'është për t'u bërë pastaj në qoftë se ne flemë gjumë siç e bëri Dimali s'bëhet me të gjitha bashkitë prej se dije ta kundërshtojmë nuk është politike kjo hiqeni mendjen që është fazi kësaj është ky kështu duhet ta duam atdheun të gjithë duhet ta duam fshatin të gjithë ta duam bashkinë të gjithë kjo është shumë e rëndësishme politik neve në këshill

po u garantoj këtë neve do t'u pyesim edhe ju kemi pyetur po pse s'doli se më erdhi në shtet pse s'doli ju atje.

Banor i NJ.A Mogilcë: Mirë. Kjo dëgjesë publike që po bëni për këto fshatra, do jetë reale apo do jetë formale? Apo se e kërkon ligji, aq sa u bëjnë popullit t'i bëjnë një furçë edhe nesër, apo vetëm është siç e kanë menduar ata? Se ata njëherë e kanë menduar, ata do ta bëjnë. Se na ka marrë një dëgjesë publike që na vjen për një rrugë këtu, para shumë vjetësh. Na kënaq, na kënaq. Më fal, na marrë një mendim. Do bëhet? A do dëgjohemi, apo do bëhet si e do ligji? Se kështu do ta bëjmë njëherë me dëgjesë edhe na e fusin e prapë, ç'është dëshira popullit? Edhe atëherë çfarë do bëjmë? Këtë e di unë. Se ne nuk jemi dakord. Edhe unë jam dakord. Edhe unë s'dua të dyshoj. Që të vetem në Korçë, nuk kam mjetet. Atëherë ne do rrishim në radhë. Ne vajtem me një autobus këtu. Do bëjmë atë që do ikë autobusi dhe do flejmë atje. Edhe na vetë për të marrë një vërtetim që jemi banues atje, për një mikun tonë, na vetë të flejmë edhe nëpër hotele atje.Si është vetë zona e vështirë. Zona është shumë e vështirë.Jemi shumë larg? Jemi 65 km larg, moj zoti.70 vjeç do të kishte makinë në dispozicion edhe s'ia rrin dot.Kështu që dimri është i vështirë, kushtet janë të vështira. Tashti të na ikën edhe bashkia. E na thonë: "Ik varet". Thoni: "Merrni një vendim, ikni o fshatarë, se s'jemi më vete. " Nuk punojmë dot më për juve. Unë këtë mendim kam. Nuk e di të tjerët.

Banor i NJ.A Mogilcë:Këshilli, së bashku me ju, janë të zgjedhur nga populli.

Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari: Po.

Banor i NJ.A Mogilcë: Vendimet e këshillit nuk hidhen poshtë në këshillin bashkiak.

Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari: Si?

Banor i NJ.A Mogilcë: Vendimin e këshillit, në qoftë se po na dëgjon, ne nuk do hamë skejt. Realisht nuk do hamë skejt, se unë jam nga Dushari, punoj. Edhe me zi. Jo të futemi ne në Korçë, për shembull, që të bëjmë punë e të marrim gjëra. Në qoftë se vendimi i këshillit, në qoftë se parlamenti e hedh poshtë, janë dakord, por ne nuk duam të bashkohemi me Korçën.

Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari: Dakord. Dikush tjetër.

Banor i NJ.A Mogilcë: Sot i zëvendësoj, ose ndoshta që janë më lart. Do t'i marrim shërbimin në qytetin, për shembull. Marrim gjë? Vërtetimet që merrni, për shembull, në bashki, do të marrim prapë aty? Se një. Edhe e dyta: përse bëhet kjo? Për të ndryshuar emrin, apo do të ulet numri i punonjësve, i rrogëtarëve? Ulet numri? Ulet numri i rrogëtarëve, apo mbetet aty? Në qoftë se ma shpjegon dot.Jo, jo, ata do ta kalojnë numrin plotësisht, se aq qëndron ky numër që ka emrin e bashkisë, dhe nesër do ta ketë qytet, apo do bjerë numri dhe do të Shërbimet nuk do t'i marrim a, por do t'i marrim kot. Se po që s'e ndryshon vetëm kjo që nuk quhet bashki, po quhet qytet, s'ka ndonjë lidhje. Po mbeten prapë ata kuadro, edhe ata punonjës që janë që rrogëtarë, prapë s'kanë ndonjë lidhje. Për këtë, për këtë desha të sqarohem.

Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari: Opinioni juaj: pro apo kundër?

Banor i NJ.A Mogilcë: Unë jam kundra që të prishet bashkia e Maliqit. Për vetë faktin, sepse është ka fshatrat më të largëta që po ta shikosh, Zerecin, Dusharin, e tëra, ne nuk jemi as me Beratin, as me Skraparin, as me Gramshin, as me këta jemi më të largët. Edhe kërkojmë shërbime që t'i kemi sa më afër.

Banor i NJ.A Mogilcë: Si banor në fshatin Zerec.Unë do them të parën, që duhet të them në fund, do ta them që jam kundra shkrirjes të bashkisë sonë. Tani do them 2 ose 3 arsye, pse jam kundra. Unë jam babai i 2 fëmijëve. Shkollën deri më sot e ka mbajtur bashkia. Nesër, po qe bashkia Korçë, këtu nuk do ketë as shkollë, as kopsht, edhe as qendër shëndetësore. Po kalojmë bashkinë e Korçës, se i shohim edhe i dëgjojmë të gjitha fshatrat e bashkisë Korçës. Për arsye i dinë vetë ata që janë lart në pushtet e si qysh tek. Po unë, me ndihmën time, edhe besoj këta që janë këtu sot, edhe si shumë të tjerë që nuk kanë ardhur, mendimi është që të mos shkrihet bashkia Maliq. Edhe, e fundit, me ndihmën edhe tuajën, edhe të administratës, edhe shumë e shumë fshatarëve të tjerë, jap një mendim: në qoftë se është e mundur, të ngrihemi dhe në protestë ta bllokojmë rrugën nacionale.

Kryetar i fshatit Moglicë NJ.A Mogilcë z.Oldi Mollaymeri:Për shumë arsye, por një ndër arsyet kryesore është mungesa e shërbimeve që do të ndodhin për zonën tonë. Ne jemi një zonë e thellë, s'kemi çfarë të flasim më tej më tutje, se nuk e dimë buxhetet e gjërave. Unë jam kundra bashkimit me bashkinë Korçë.

Banor i NJ.A Moglicë: Po na iku atje lart, në Korçë, ne na mbaruan fare. Ne e kemi proven me Komunën.

Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari: Je pro apo kundër bashkimit me Korçën?

Banor i NJ.A Moglicë: Jam kundra plotësisht.

Kryetar i fshatit Popçisht NJ.A Mogilcë z.Arianit Llazi: Them që, pse të ikim nga bashkia e Maliqit? Të mos shkrihet. Edhe aty, edhe mezi i bëjmë punë.

Kryetar i fshatit Gopesh NJ.A Mogilcë z.Hydri Kula: Pse? Të flas vetëm një frikë të vogël që më ka ndodhur mua, fajtë muajit korrik. Më ra, ra breshëri, mori gjysmën e fshatit e çanë mes për mes. Tashi, në këto pozicione, i mora administratorin, administratorii tha: "Do t'i thojmë edhe kryetarit të bashkisë. " Brenda 24 orëve, jo 24 orë, por 24 orë, se unë i thashë në mëngjes ditën tjetër erdhi. Më bëri: "A do pyesim ne për Gopeshtin, ose për Dusharin, ose për Ikësin? " Erdhi Fadroma, erdhi. Dy ditë erdhi Fadroma. Ndeqi dy ditë. E bëri. Si e bëri? E bëri. Por Fadromi ka rrënjë në Gopeshë.Ore, është fakt.Jam kundra bashkimit me Korçën.

Banor i NJ.A Moglicë: Unë kam një gjë: edhe meqë e njohim tërë zonën, edhe po dal nga Dushari, unë nga Pulha jam larg se ty, sot.Larg je, keqkuptohesh. Po nuk diskutohen këto gjëra sot, se edhe dje, pse nuk i diskutuam dje këto, po i diskutojmë sot. E kur u bë malli, unë jam që, , ne qeverinë e kishim, Ishte komunë. Unë kam qenë kryeplak te ndarëm, pothuaj. Ja ku janë shokët, varianti

është tjetër.Edhe dua t'ju sjell një shembull, që pse e kërkoj këtë. Ti, apo unë, unë më shumë jam për këtë, për qendrën, të forcohet, çfarë do bëhet këtu, sesa atje. Ajo le të shkojë në Tirana, se s'më duhet mua punë e qendrës. Mua këtu i shërbehet popullit, këtu. E kishe buxhetin tënd, edhe i dhanë një mbledhje këshilli. Kam qenë kryepleq, kam qenë këtë, kështu. Edhe mblidheshim çdo muaj atje, edhe ndashe buxhetin, grishej, më ngrite mua kryetari I Komunës.

Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari: Me pak fjalë, të fuqizohet. Të fuqizohet njësia administrative.

Banor i NJ.A Moglicë:Të Fuqizohet? Ore, të prishet bashkia. Mua më duhet të forcohet qendra, që të marrë zhvillim.Të forcohet NJ.A Moglicë.

Administratori e NJ.A Moglicë z.Fetah Hoxha: Ju falenderojmë për pjemarrjen.

Kryetari i Këshilltit:z.Ornildi Demollari: Ky ishte takimi.Faleminderit!

Mbajtës Protokolli!

Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

SEKRETARI I KËSHILLIT

Datë 19.08.2026

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 19.08.2026, në konsultimin Publik, në ambjentet e NJ.A Gorë Projektligji: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë. ora 11:00.

Të pranishëm:Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi;Sekretari i Këshillit:Gertjan Gjiriti; Këshilltarët:z.Selami Muço, z.Lulëzim Hoxhaj, Yllson Ibrahimllari;Administratori e NJ.A Gorë z.Ronaldo Skënderi ; Kryetarë fshatrash; banorë të NJ.A Gorë; sipas listës bashkangjitur.

Administratori i NJ.A Gorë z.Ronaldo Skënderi: Përshëndetje! Kemi përfaqësues të Këshillit këtu.Ishte edhe kryetari i këshillit, po kishte një problem familjar, nuk e kemi ku ndodhet. Atëherë, dua të bëj edhe një, si të thuash, të jap edhe mendimin tim në lidhje me këtë çështje që jemi mbledhur sot, në lidhje me draftin e ri që ka dalë për ndarjen e re administrative territoriale. Nuk dua të zgjatem shumë, pasi çdokush nga ne mund të japë edhe, si të thuash, atë mendim që ka, ose siç e shikon vetë. Unë dua po ashtu të jap edhe unë atë mendimin tim në lidhje me si e shikoj unë personalisht rreth torës. Nuk ka asnjë gjë, si të thuash, për t'u patur "o bobo, çfarë do ndodhë", se po shikojmë shumë edhe nëpër media që me ndarjen që mund të bëhet, po do të shkrihet gjithçka. Kjo nuk është e vërtetë. Ato pyetjet që ngre çdokush, që ngre edhe unë, janë: a do të kemi më shumë investime në Gorë, a do të kemi më shumë mundësi zhvillimi, a do të kemi më shumë mundësi në infrastrukturë. Pasi ne e dimë të gjithë problematikat e kësaj zone, kjo zonë kërkon më shumë, më shumë investime. A do të kemi më shumë shërbime? Këto janë ato, si të thuash, ato pyetjet që duan një përgjigje shumë, si të thuash, konçize. Nuk dua të siç e thashë pak më lart, nuk dua të zgjatem, por në vija të përgjithshme ky është mendimi im. Në qoftë se ne do të kemi më shumë investime, më shumë mundësi zhvillimi, atëherë nuk ka asnjë problem. Ne këtë e shikojmë si një mundësi dhe jo si një, por në qoftë se është e kundërta, atëherë duhet parë me shumë kujdes. Nuk e di nga këshilltarët.

Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi:Përshëndetje, zoti kryetar. Edhe ata që nuk kanë patur mundësinë të marrin pjesë në këtë djegës, siç e tha edhe djali i administratorit tuaj, që është në djegës publike, por unë gjithmonë jam i pakënaqur në këto historira, sepse në djegësat publike populli duhet të ketë më shumë forcë, më shumë organizim, më shumë organizim. Dua të falënderoj edhe këshilltarët që janë këtu, nëse më lejojnë udhëzimin. Dhe sekretari i këshillit ishte edhe me kryetarin aty; po kryetari kishte një problem familjar, dhe administratë me makina shkoi poshtë. Ndjesë, ju kërkojmë edhe për vonesën që u vonuam pak, për këto arsye. Tashi, siç e tha edhe djali, neve si këshill i bashkisë Maliqit, në kuadrin e reformës territoriale, është bërë një projekt vendim; s'është bërë vendim, mos ngatërrojmë gjërat. Ne insistuam për të bërë këtë dëgjesë

siç e kërkon ligji dhe rregullorja e këshillit të bashkisë. Dhe sot është dëgjesa e fundit që po e bëjmë në Gorë, dhe i kemi bërë dëgjesat në të gjithë ish-njësitë administrative, ku i kemi dëgjuar, dhe në shumë sot kemi ardhur të dëgjojmë juve, mendimin tuaj për këtë që është nisur si projekt vendimi që i ka kaluar parlamentit, duke e parë dhe miratimin nuk është bërë. Gjithsesi, secili nga ju ka të drejtën e fjalës, të reagojë, të shikojë: këtu nuk është çështje politike, këtu është çështje sepse ka të bëjë me shërbimet që kërkon secili familjar, secili individ. Në shkallë më të lartë dhe më të prekur në këtë reformë mendoj unë, është njësia e mobilitës dhe juve. Kjo është më se e vërtetë. Unë isha edhe në Zarec, në Moglicë, bëmë edhe dëgjesën atje, por që jemi në Maliq, në këtë largësi, po të jemi në Korçë, akoma më keq. Dhe shumë gjëra, unë si këshilltar, ose në kryetari i këshillit të bashkisë, e kam diskutuar edhe në djegës shumë të ndryshme, edhe në takime. Unë jam kundër këtij bashkimi me Korçën, sepse e them edhe këtë me bindje: sa më shumë të kemi, edhe në familje kur janë 3-4 djem duhet, që t'i ndajmë, që të kenë 2 televizora, të kenë 5 kështu dhe 5 kështu, këta duhet të na bashkojnë dhe të bëhet një. Për mua kjo ka një sens të keq. E kam thënë dhe e them dhe do ta them edhe këtu, dhe nuk do të zgjatem, sepse kërkojnë të humbasin mekanizmin e votës. Se kur të bëhet bashkimi me Korçën, administratori do quhet ai, siç quhen këta djem, pse do quhet ai Maliq? Do jetë i emëruar. Kështu që do të thotë, kjo zvogëlohet, dhe qeveria, kushdo që të jetë sot, që është dhe nesër, do ketë: emëro këtë, bëj këtë, dhe nuk do të jetë bota. Dhe ky është një problem i madh për shqiptarët bota. Dhe ne, unë mendoj që ne duhet të japim mendime të pjekura, dhe mendoj që ne të mos e pranojmë këtë ide. Pastaj, se çfarë do bëhet, por ne si këshill ju garantojmë që mendimet tuaja, siç i kemi mbledhur nga të gjitha, do të bëjmë formularin përkatës për zyrtarin dhe do t'ia relatojmë ne që kemi ngritur këshill për këtë qëllim. Jashtë rradhës, dhe do ta bëjmë këtë punë ashtu siç janë shprehur.

Këshilltari i NJ.A Gorë z.Selami Muço:Përshëndetje! Zonë nga më të largët, të thellohet edhe një herë më tutje vështirësitë e, pra nuk do futemi shumë në këto, se sa te ajo që duket sikur nuk ka patur efektivitet. Është e vërtetë. Për zonën tonë, thuajse për mua, bashkia e Maliqi e ka emrin bashkia e Maliqit, po për mua ka qenë më shumë bashkia e Maliqit dhe e fushës së Maliqit. Po të jetë për zonën poshtë, domethënë zonë Gorë e Opar që ke me turizëm, unë jam i pakënaqur, në kuptimin pse janë bërë shumë pak gjëra.Aq më tepër që infrastruktura rrugore s'përdoret shumë. Në qoftë se këtë diçka dhe mund të bëhet në zonën tjetër, këtë është e pa-llogaritshme fare. Për shembull, zona e Gjyrasit, Bickës, Lozhanit, Korçës, që janë këto janë, nuk janë fare në nivel të artë. Ashtu. Pra, pavarësisht që këto defekte janë, nuk do të thotë që bashkia nuk do të jetë. Bashkia duhet të rritë efektivitetin e punës, po efektiviteti është i ulët. Jo se është bashkia, domethënë, e domethënë që nuk funksionon si duhet. Prandaj, në këtë aspekt, unë mendoj që të rritet efektiviteti, të shtohen investimet, të futen, domethënë, investime tamam. Ka kaq vjet do bëjmë rrugën e Sterelcës, asfalt. Ka kaq vite që nuk është bërë 100 metra asfalt. U bënë 500 metra vjet, nëse do bëhen sivjet apo jo, apo do bëhet vitin tjetër apo jo. Prandaj, zona është trajtuar jo mirë. Dhe në qoftë se bashkia duhet të qëndrojë dhe do qëndrojë, duhet të përqendrojë vëmendjen kështu, pa harruar fushën për të cilën është bërë mjaftueshëm, them unë. Jo se s'duhet bërë. Po ama, duke qëndruar bashkia, domethënë, në këto pozicione, duhet të ndryshojë edhe metodën e punës, edhe efektivitetin e punës. Përfundimisht, unë jam dakord që bashkia të qëndrojë, të mbetet, se mos që të jemi, mos të qenë bashkia e Maliqit humbet identitetin e zonës, identitetin e qytetit, që është një qytet me emër, edhe do ndodhë siç ndodhi me njësitë administrative, siç jemi ne këtu tani, që thuajse edhe këtu i ka humbur ajo vlera që kishte përpara, Lozhan apo barangët e Zenishtit, si quheshin. Është thjesht një rrugë kalimi, domethënë, nuk pyet njeri pse do të jetë komuna.

Kryetar i fshatit Lozhan NJ.A Gorë z.Ylli Gozhdari: Unë jam shumë dakord me këtë që parafolësit e tha, s Megjithatë, shumë është e vështirë në Maliq, se që nga Moglica duhet gjithë ajo kohë për në Korçë.Ore, dëgjo, edhe në Maliq, edhe në Maliq unë duhet të paguaj 6,000 lekë për çerek të katërt.Nuk e vendos në njësia.Për shambull, Pojan. Të jetë bashki më vete. Maliqet mos shkrihet. Më kupton? Maliqi mos shkrihet. Bashkia e ndaj, le të ndahet ajo fusha.

Banor i NJ.A Gorë: Jo, jo, unë vetëm një gjë po them: unë nuk do ta lë bashkinë e Korçës. Unë nuk do votoj për atë. Nuk votoj për Korçarët. Unë e dua Korçën sa më afër. Edhe ti e the vetë. Ja, unë dy dje kisha për një ndarje, marrëdhënie të mira, edhe eci sot mirë e bukur. Tashi, hajde të bashkohemi të bëhemi edhe agjendë aty, edhe pastaj gjejmë ndonjë tjetër. Unë e kam afër atë djalin, edhe atë atje veten. Veten e Korçës e ka urdhëruar në qoftë se nuk ka urdhër, nuk e di.Faleminderit.

Kryetar i fshatit Velçan NJ.A Gorë z.Viktor Hoxhallari: Për të folur, kemi shumë për të folur dhe për të kërkuar. Por sot nuk jemi mbledhur për të kërkuar gjëra të tilla. Sot jemi mbledhur: jemi dakord për heqjen e bashkisë, apo s'jemi dakord? Unë personalisht nuk jam dakord për të mbyllur bashkinë me ligj. Mirë. Po të jetë për punë të tjera, që çfarë është bërë këtu, nuk është bërë shumë.

Banor i NJ.A Gorë: Nuk jemi dakord për këto lloj që bashkia të shkrihet, po kemi edhe shumë kërkesa. Neve taksat i paguajmë për varrezat, për tërën. Vjen puna të na betohet, djalë. Po të vish të shikosh varrezat tona në Lozhan, është për tu. As i pari festim. Një rrugë u fut aty për dimër, u shquen njerëzit se erdhën me gurë, me krahë, me këtë. Sa? 5 metra gjatësi. S'e bën, e s'e bën. Edhe prapë është ashtu. Kam dhe një gjë tjetër: unë po e çaloj. Ka reshje shirat, rruga ka plot një vit, nuk erdhi një Fadromë ta pastrojë.

Këshilltari i NJ.A Gorë z.Yllson Ibrahimllari: Folën edhe të gjithë. Unë jam Yllson Ibrahimllari, djalë nga Veçani, mik i moçave. Jam këshilltari juaj. Sa më keni sharë, sa më keni lavdëruar, sa s'më keni parë, sa s'keni dashur të më shikoni, kjo është një histori e gjatë. Dhe ju, gjërat janë të thjeshta. Ajo pyetja që shtrove ka dy diskutime shumë të thjeshta: njësia administrative ju tha administratorit që do ekzistojë. Do ekzistojë si duhet, apo do ekzistojë siç është tani, që për mua nuk është e duhura? Dhe jo për faj të atij zotërisë, ka qenë këshilltar si unë. Kjo është histori tjetër. Shembull jemi të gjithë, edhe unë që jam më i vogli i ndërrimit në një farë mënyre. Shembull është i thjeshtë: kishim dikur një infermiere, kishim dhe një mami që priste lindjet. Kishim dhe doktor, Ameti i atij zotërisë nga Velçani dhe i këtij zotërisë tjetër, dhe i imi ishte doktor Moglic. Filani ishte këtu në Lozhan, që ende s'ia kemi vënë emrin e madh "Syrja Jahollarit". Doktorin e kemi pensionist, burrë të nderuar, s'kemi të tjerë u shpërbër. Shkollën deri diku e kemi të mbajtur në këtë lloj realiteti. Kush është problemi? Qeveria, që duhet ta bënte këtë platformë, këtë ndarje. Nuk e ka bërë këtë ndarje qeveria. Qeveria ia ka kaluar parlamentit. Në fakt, do ishte mirë që këtë nismë ta merrte qeveria dhe të mos e lëvishinte me parlamentin, me komision, dy partizanë apo tre partizanë e katërballistë. Pse? Sepse ne sot s'kemi një reformë territoriale e cila do të thotë kontroll të territorit, që do të thotë kontroll të shërbimeve. Edhe nga 2015-a, dhe më përpara, edhe që nga koha e Fidaiut, kryetar komune, komuna e Gorës nuk ka pasur topograf. Të gjitha shtëpitë, ai zotëria Krushku im aty, e ka shtëpinë pa certifikatë në Velçan. Në Velçan, përveç meje, ka dhe Arusha certifikatë. Certifikatë nuk ka. Ka një problem shumë të madh ajo harta e Velçanit, se ka hyrë mes malit me tërë pyllin e vet deri nga Velçani, e s'e di ku i ka dhe kufijtë e fshatrave. Këto

janë ca detyrime që, edhe sido që të vejë fati i bashkisë, me nismën tuaj, me nxitjen tuaj, edhe me vëmendjen time, për shumë arsye ato çfarë ka mundësi, do t'i bëjmë në bashkëpunim neve administratorët. Problemi që ndodh: që kjo reformë nuk është reformë administrative. Ky projekt është një reformë bashkish. Po të doni, për ta bërë administrative, e kishim bërë, fare kollaj. Është më afër të vish nga Gurikamjës për të vajtur në Bodeve, në Voskopojë, sesa rruga e Dardhës nga Devolli në Sinic. Por që të zhvillohet Dardha dhe të ecin andej-më-andaj nga i kanë punët ata zotërinjtë, ju bie më mirë ky projekti. E kanë sjellë deri te Gurikamjës atë rrugën. Që nga Gurikamjes, në Osmak, poshtë aty buzë lumit, pa argjime të mëdhaja, edhe dilni direkt në Qukës juve. Edhe na duronit, e s'na duronit. Më thoni të nderuar kryepleq, kryeplaku, ne jemi kthyer si institucion për të raportuar kush ka mbjellë dhe kush nuk ka mbjellë hashash. Asnjë fuqi s'kini, asnjë vlerë nuk ka ajo firma dhe vula juaj. As mbi rrugët që ja u jep ligji, as mbi kontrollin e shtyllave dhe atyre izolatorëve, si quhen ato, porcelanet që vihen te shtyllat, i keni të gjithë. Shkoni edhe atje ku punoj unë, Velçan, te ëra ime, është e sakatuar. As pyet ajo e elektrikut, as pyet. Ne do ta bëjmë reformën administrative për të qenë për juve, në momentin që kryeplaku i fshatit është zot i shumë punëve. A ka mundësi? Do thuash: je kundër, je pro asaj sistemi që e kishte dhe maminë e fshatit? Janë pritur lindje këtu në këtë qendrën shëndetësore. Sa vite kemi pa parë ndonjë bebe që të lindë këtu? Ma thoni. Jeni më të mëdhenj për këtë. Të lutem, përveç asaj, se ky është luks i madh, se do edhe doktorët. Të lutem, çfarë reforme administrative? E lirë, kripa në Durrës, thoshte im atë , po e ha qera e rrugës. Gjithsecilit prej neve shërbimet që kemi i duhet të shesim një kec, maksimumi një ftujak, për të shkuar për të mbyllur një problem dokumentash në Korçë, dhe pa lekë do të ketë ndonjë mik të mirë që ta mbajë për darkë, mos paguaj hotelin. Kjo zonë është e harruar, me ndihmën e atij zotërisë që ka bërë punë të mirë dhe lavdëruese, e sollëm në Epiqendër dhe u bë Velçani si me unazë për t'u ardhur. Po tërë rruga nga tri urat, me gjithë erën e emergjencave civile, e bëhen e tjera. Asnjë kanal nuk ka, rruga të hapur, dhe ajo rrugë nuk e mbyll këtë dimër. Edhe ti, kryeplak që je këtu, edhe ai kryeplaku që mungon sot i Mesmalit, edhe ti, Krushku im, që kalon përditë aty. Ajo rrugë, e mori atë çakullën që është hedhur dhe ajo nuk bëhet. Edhe të gjitha ato debatet e bëra në këshill bashkiak, të ardhura vërdallë. Ata po rrejnë se jemi ngritur bashkarisht. Ata po rrejnë, janë të tharë në behar. Edhe ne nuk besojmë që do mbjellim më grurë, as sej, as tërshërë, as me Strelcë, as në Velçan, të cilët do na bëjnë neve një zonë kaq të mirë bujqësore. Ne me blektori do të jetojmë. E çfarëdo që të thoni juve, edhe nëse vjen ajo koha ndaj madame, siç ishte Qemoti, që për mua mosardhte, edhe për shumë të tjerë, me vuajtjet e mos shpërblimit, unë prapë edhe doktor, doktor burgu jam. Doktor burgu bëj, por një gjë kam: çfarëdo që të bëni me këtë reformë territoriale, kjo është reformë vasalësh. Sapo të ktheni kurrizin në kartë, në Korçë, në takimet e zyrave që do keni, do keni këtë doktor. Lëreni një çik atë agajin, atë kokëzhebjen e Strelcës e të Velçanit, të paguajë. Se agallarët do paguajnë për neve, siç kemi paguar Qemoti. Këtu nuk shtrohet çështja kujt i përket e kujt i bën. Se po t'i kishim bërë kaq mirë punët, po t'i kishim bërë kaq punët, ne kishim dhe deputetë këtu. Kishim deputetë këtu prezent, dhe me mandat kryeministri. Dhe deputeti me mandat kryeministri nga kjo zonë njësoj dy gjëra: të kërcente valle gorare, edhe të pinte raki mirë . Zotësinë, për të ardhur, unë mendoj që kjo reformë, nesër në këshillin bashkiak, unë i përkas një grupi që e kemi firmosur, e kemi bërë publike për interesat tuaja, nëse ju e gjykoni ndryshe, dhe ne kthejmë mendim nëse ju dilni me një version tjetër. Kjo reformë nesër, grupi që përfaqësoj, prej 11 këshilltarëve, dhe nënkryetarin e këshillit, edhe këshilltarin tjetër të Moglicës, ne do ta votojmë, edhe këshilltarin tjetër, ne do ta votojmë kundër. Për një arsye të vetme. E para se kemi argumente të mëdhaja deri këtu ku qeni, për një arsye të vetme, se në qoftë se sot projekti që ka sjellë qeveria, e sjell si projekt të dështuar për

vjedhjen e taksave, për mbledhjen e anës ekonomike, dhe si një nga bashkitë që, pavarësisht hapësirës gjeografike, numrit të lartë të popullsisë, që e ka vetëm Divjaka dhe Maliqi, nuk ka vjelur dot të ardhurat, nuk ka zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, ne themi t'i kthejmë zhvillimin ekonomik, të kthejmë epiqendrën, por nëse nuk vjen taksat, nëse s'ka zhvillim ekonomik, dhe kjo bashki, për fajin e kujt paska ardhur kjo bashki deri në këtë derexhe, që të themi ne: hajt të shkojmë andej-më-andaj, se të shikojmë sa mirë. Faleminderit!

Kryetar i fshatit Strelcë NJ.A Gorë z.Alfred Skënderi: Po mua më duhet edhe një gjë shumë, domethënë, që ne të flasim edhe një çik kështu, sipas oreksit. Jo oreksit, por domethënë, të painformuar mirë. Se as edhe juve, as edhe kryetari, as edhe këshilli, as edhe njeri nuk e di, domethënë, plotësisht. Ne këtu kemi një të metë: që draftin e kemi parë, e kemi shpjeguar draftin, se disa gjëra nuk janë ashtu siç duhet, domethënë, disa gjëra. Se mirë, dakord, tha doktori që s'kemi patur shërbime, po me reformën e 2014-ës jemi si dita me natën, ajo e kishim. Jemi si dita me natën. Se nuk jemi nga ata që të themi "s'janë bërë gjërat". Janë bërë disa gjëra. A duheshin më shumë? Po, dakord, duheshin më shumë. Duheshin më shumë, duheshin. Po ujësjellësat janë bërë. Disa rrugë janë bërë. Domethënë, këto 10. Duheshin bërë në shumë kohë, po duheshin bërë në shumë kohë. Tha doktori, për shembull, që reformat ne i dimë gjithkund, të bëhen për mirë. Se në qoftë se ne e bëjmë bashkinë, për shembull, siç ishim, kemi të ardhura neve? S'kemi. Ku do t'i gjejmë lekët? Me çfarë rroge do t'i gjejmë? Do marrin 5 veta rrogën. Po jo, mo, po pastaj marrin ata 5 veta rrogën. Ne duhet të kemi edhe të ardhura. Kështu që, disa gjëra ne jemi të painformuar mirë. Se ne vetë do të s'kemi çertifikatë. Çertifikata është normale. S'ka problem fare me çertifikatën. Çertifikata është normale. Siç thoshte një nga fshatit tuaj andej, atij: Jo, mos vetëm. Edhe si ka kaluar njeri. Edhe si ka kaluar njeri. Po duhet shumë gjëra. Ne të kërkojmë po, jam dakord unë. Ne të kërkojmë, domethënë, që çfarë do kemi, si do bëhet, të të riregjistrojmë, të themi, ore, do t'i kemi këto gjëra apo s'do t'i kemi. Atëherë pastaj dalim edhe që themi: "O, këtu ju po na gënjeni. " Neve sot është projekt. Se disa reforma u bënë mirë. Disa reforma, për shembull, reforma për mjedisin, për të tjerat, u bënë mirë. Domethënë, reforma në elektrikun u bë shumë mirë. Domethënë, mjekësinë që tha ky. Vërtetë atij që ne kemi spital, doktor, po s'e kemi më. U prishën kanë 35 vjet. Se tash janë sistemi 50 vjeç, e kthyem një sistem tjetër. Ky sistem do të numrin e popullsisë. Numrin e popullsisë s'e kemi. Tashi neve vuajmë. Vuajmë, dakord, doktor, s'kemi. U bë një shembull, se mos ju mbaj edhe unë shumë gjatë, se po flas edhe të tjerë. U bë një draft ligj për doktorët, të punojnë 3 vjet. Të tërë formi. O, çfarë do të bëjmë? Do ikim këtu. Po do punojmë, se bëre shkollën, dole këtu, të punoje 3 vjet, të vijë doktor i ri. S'ka. Jo, mos ta hyjmë këtë ligj. Se do ikim jashtë ne.Faleminderit!

Kryetar i fshatit Zvarisht NJ.A Gorë z.Nazif Bashllari: Unë jam dakord të ndahet bashkia e Maliqit, të ndahet të dy e fushave: njëra në Gora e Maliqit, tashmë dhe tjetra në Bashkimin e Korçës. Ndahet e njëjtë, jo të bashkojmë me Korçë. Nuk jam dakord për bashkimin e Maliqit me Korçën.

Këshilltari z.Lulëzim Hoxhaj: Unë nuk banoj në Tiranë. Unë banoj në Tiranë. Jam me origjinë nga Nikollara. Me thënë të drejtën, nuk e kam këtë çështje personale; e tjera, e tjera, unë kam zgjidhur problemet se jetoj, thashë, në Tiranë. Por, me thënë të drejtën, në dy vende dua t'i them ashtu, shpjegoj para. E para njëherë është një parim i përgjithshëm, se pothuajse i sqaroj edhe doktori, edhe të tjerë që folën, sqarojnë shumë gjëra. Por ka një parim: sa më larg qendrës të jetë

shërbimi, aq më i zbehtë dhe aq më i vogël bëhet shërbimi. Dhe shërbimi sa më afër të jetë, aq më efektiv dhe aq më i mirë është. Kështu që, si tha ai, tha: "është mirë të kesh lekë apo mos kesh lekë". Kjo është çështje për t'u habitur, për t'i dhënë një përgjigje. Që do të thotë: bashkia, jo bashkia e dikush tha që edhe ky bashkim mund të bëhet, është më mirë akoma. Pra, këtu se si është efektiviteti pastaj është histori tjetër. Por bashkia e Maliqit, të paktën kështu siç është, nuk duhet të lëvizë dhe nuk duhet të bashkohet me atë, me bashkinë e Korçës. Unë kam, vite e vite më parë, kam punuar edhe në, kam punuar, kam qenë edhe agronom, 12 vite në NB-nëMaliqit, ish-NB-në e Maliqit. Po jua them me përgjegjësi: Maliqi, si bashki sot e këtej mandej, është qendra më e madhe ekonomike-bujqësore që ka Shqipëria. Është tjetër gjë çfarë efektiviteti ka, si është organizuar, çfarë probleme ka, si mund të organizohet. Këto janë probleme të tjera, por si. .. si territor, si vend, fermerë, si aktivitet ekonomik, si popullsi, është një nga podhimet më të mëdha që ka Shqipëria. Është turp të diskutohet të shkrihet apo mos të shkrihet, edhe të kalojë me Korçën. Dikush, në një dëgjesë që u bë në Korçë, hodhi një ide dhe tha: "është më mirë, tha, të bashkohet Korça me Maliqin". Po, po, të jetë fjala për bashki, më mirë është Korça, të dihet çfarë ka Korça. Prandaj, unë dëgjova me kujdes këtë fjalë, plotësisht, plotësisht dakord me idenë dhe me mendimin tuaj që neve duhet të jemi shumë konsekuentë në këtë, në këtë ashtu. Dhe të di edhe një gjë: dëgjova pak administratorin, që në fillim fare, me fjalë që tha që "po, po, tha, do jetë kjo qendra, kjo qendra administrative do jetë", tha. E për mua është e dyshimtë, do jetë apo nuk do jetë. Pse? Po u bashkuam. me atë, meqë bëhen nja 14-15 qendra administrative. Mendo tani, mendo se si mund të organizohet, se asgjë nuk dihet se si do të e tha doktori. Këtu bëhet fjalë për reformë për bashkinë, bashkinë, bashkisht. Nuk bëhet fjalë pastaj si do të konceptohet bashkia, sa qendra administrative do të ketë. Sa do ketë, si do të jetë, po siç kishe rrethet, rrethi i kategorisë së parë, të dytë, të tretë. Kanë edhe funksion në atë fushë, pavarësisht nga mendimi personal që kanë. Edhe e kam shprehur edhe në këshillin bashkiak, për administratën, për mënyra se si është konceptuar, si është po, me thënë të drejtën, edhe ata njerëz që punojnë sot në administratë ushqehen me atë, edhe jetojnë me atë. Ore, si është e mundur që njerëzit e administratës, që sot cënohen shumë, le të mos jetë një përrallë kjo, që të gjejnë se nuk do lëvizin gjërat? Kështu do jenë? Jo, mor jo. Nuk do të jenë kështu. Po të bashkohen me ta, do jenë shumë, për mos thënë më pak se gjysma e kësaj administrate. Më pak se gjysma. Edhe do jesh, do jesh tamam, tamam, tamam me ta. Pastaj vjen puna tjetër: qendra do jetë në Korçë dhe çdo gjë organizohet vetëm në Korçë.Faleminderit!

Banor i NJ.A Gorë: Unë nuk jam dakord me bashkimin e bashkisë së Maliqit me atë të Korçës. Me kaq, dhe s'po merrem me çdo gjë. Kaq.Faleminderit.

Banor i NJ.A Gorë Unë kam ardhur këtu për dëshmi. Për dëshmi?Për të parë dhe të zonë këto. Për dëshmi. Ja vini vesh: nuk kam ardhur të dëgjoj neve të bashkohemi me Korçën apo të mos bashkohemi. Jo në një vend. Unë kam folur shumë kurdo, por në '81 kam shpëtuar përballë. Dëgjoni: a do t'i venë këto fjalët që them unë kryetarit të parlamentit që është nga Korça? Unë nuk akuzoj njeri, por strehëta quhet "Gorë e Opar". Jam nga Stelca, pothuajse nga Gora. Jemi dakord, s'jemi dakord. Këtë e ka vendosur një që thotë "nuk jemi të informuar" apo sidoqoftë. Po po dëgjoj që "si të qenë kemi dakord neve" apo "të mos jemi dakord". Sepse do na kur të jetë Bashkia e Korçës.Unë jma të bashkohemi me bashkinë e Pusctecit kaq kisha.

Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi:Nëse nuk kemi diçka tjetër? Kjo ishte dëgjesa.Faleminderit.Ditë të mbarë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbajtës Protokolli!

Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

SEKRETARI I KËSHILLIT

Datë 13.08.2026

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 13.08.2026, në konsultimin Publik, në ambjentet e NJ.A Libonik Projektligji: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë.
ora 10:00.

Të pranishëm:Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari, Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi; Sekretari i Këshillit:Gertjan Gjiriti; Adminitratorja e NJ.A Libonik znj.Rudina Bregu; Kryetarë fshatrash; banorë të NJ.A Libonik sipas listës bashkangjitur.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari Mirë. Mirëdita të gjithëve dhe faleminderit që jeni bërë pjesë e këtij takimi. Ky është një takim dëgjesë publike, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë. Po them: elementët nuk janë të ngjashëm nga Bashkia e Maliqit tek Bashkia e Poliçanit. E mora. Pasi Bashkia e Poliçanit mund të ketë qenë në listën e propozimit për bashkim për numrin e popullsisë. Po, e marr. Ndërsa Maliqi nuk është, nuk propozohet për t'u bashkuar nga elementi i popullsisë. Maliqi propozohet për t'u bashkuar për të fuqizuar kapacitetet financiare, për të fuqizuar kapacitetet tek burimet njerëzore, dhe duke u favorizuar nga afërsia me Korçën.Po ju them disa nga avantazhet dhe disavantazhet e kësaj reforme që mund të kenë banorët e bashkisë Maliq.

Për komunitetin e Maliqit pyetja është më konkrete:

Çfarë do të fitojë ose humbasë Maliqi nga integrimi me një bashki ekonomikisht dhe financiarisht më të fuqishme?

Konsultimi duhet të fokusohet në:

- financimin e shërbimeve;
- investimet në territor;
- punësimin dhe ekonominë lokale;
- zhvillimin rural dhe bujqësor;
- aksesin në shërbimet publike;
- ruajtjen e identitetit dhe rolit të komunitetit të Maliqit.

Bashkia Maliq ka aktualisht të publikuara konsultime për PBA 2026–2028, planin e menaxhimit të mbetjeve, planin social, arsimin dhe dokumente të tjera strategjike, çka tregon se konsultimi mund të strukturohet mbi nevojat konkrete të komunitetit dhe jo vetëm mbi çështjen administrative të bashkimit.

2. Çfarë tregojnë treguesit për Maliqin?

Treguesi	Maliq	Korçë	Diferenca
IFB – kapaciteti financiar	49,7	70,2	-20,5
IPE – performanca ekonomike	26,2	55,2	-29,0
IMU – kapaciteti urban/infrastrukturor	49,4	88,6	-39,2

Treguesi më problematik është IPE 26,2.

Pra, dobësia e Maliqit është kryesisht **ekonomike**, ndërsa jo domosdoshmërisht një dobësi e plotë në të gjitha dimensionet.

Ky është një element shumë i rëndësishëm për konsultimin:

Maliqi nuk duhet të paraqitet si një bashki që nuk mund të funksionojë, por si një bashki me kapacitet ekonomik dukshëm më të kufizuar dhe që mund të përfitojë nga lidhja me një qendër më të fuqishme ekonomike.

3. Çfarë mund të fitojë Maliqi?

Mundësia kryesore është aksesimi i kapacitetit të Korçës.

Kjo mund të nënkuptojë:

- akses më të madh në investime;
- përmirësim të infrastrukturës;
- shërbime më të specializuara;
- akses më të mirë në tregun e punës;
- lidhje më të forta me bizneset e Korçës;
- mundësi për zhvillimin e bujqësisë dhe agropërpunimit;
- projekte të përbashkëta për turizëm, bujqësi dhe mjedis;
- kapacitet më të madh për përfitimin e fondeve të zhvillimit.

Në këtë kuptim, afërsia Korçë–Maliq është një avantazh i rëndësishëm, sepse integrimi ekonomik dhe funksional mund të jetë relativisht i lehtë.

4. Çfarë rrezikon Maliqi?

Kjo është pjesa që duhet diskutuar më hapur me komunitetin.

Rreziku kryesor është periferizimi i Maliqit.

Komuniteti mund të shqetësohet se:

- investimet do të përqendrohen në Korçë;
- shërbimet do të centralizohen në Korçë;
- qyteti i Maliqit do të humbasë funksionet administrative;
- zonat rurale mund të marrin më pak vëmendje;
- punësimi në administratën lokale mund të reduktohet;
- identiteti dhe roli i Maliqit mund të dobësohen.

Prandaj, çdo model konsolidimi duhet të shoqërohet me pyetjen:

Si garantohen shërbimet dhe investimet për komunitetin e Maliqit pas konsolidimit?

5. Çfarë duhet të kërkojë komuniteti i Maliqit?

Konsultimi mund të fokusohet në identifikimin e garancive konkrete.

Komuniteti mund të diskutojë:

1. A duhet të ruhet Maliqi si qendër lokale e shërbimeve?
2. Cilat shërbime duhet të vazhdojnë të ofrohen në Maliq?
3. Cilat investime janë më urgjente?
4. Si duhet të mbrohet potenciali bujqësor i zonës?
5. Si mund të lidhet prodhimi bujqësor i Maliqit me tregun e Korçës?
6. Si mund të sigurohet që konsolidimi të mos sjellë vetëm centralizim, por zhvillim ekonomik lokal?
7. Cilat janë kushtet që komuniteti do ta konsideronte një konsolidim të pranueshëm?

Mesazhi për komunitetin e Maliqit

Çështja nuk është vetëm nëse Maliqi duhet të bashkohet me Korçën, por çfarë modeli konsolidimi do të sigurojë që potenciali ekonomik dhe territorial i Maliqit të shndërrohet në investime, punësim dhe shërbime më të mira për komunitetin.ta bërë konsultimin të krahasueshëm, do të rekomandoja që në fund të dy takimeve të përdoret e njëjta pyetje:Nëse Korçë–Maliq do të konsolidoheshin, cilat do të ishin tre përfitimet kryesore dhe tre rreziqet kryesore që duhet të merren parasysh? Dhe veçanërisht të kërkohet nga pjesëmarrësit të vlerësojnë pesë fusha:

Fusha	Korçë	Maliq
Financat dhe buxheti	A sjell më shumë të ardhura apo kosto?	A sjell më shumë kapacitet financiar?

Fusha	Korçë	Maliq
Investimet	A rritet potenciali për investime?	A rriten investimet në territor?
Punësimi dhe biznesi	A zgjerohet tregu ekonomik?	A krijohen më shumë mundësi punësimi?
Shërbimet publike	A ruhen standardet aktuale?	A përmirësohen shërbimet?
Identiteti dhe përfaqësimi	A forcohet roli i Korçës?	A ruhet roli dhe identiteti i Maliqit?

Përfundim për procesin e konsultimit

Në këtë mënyrë, takimi në Korçë duhet të fokusohet te pyetja "çfarë përfiton Korça dhe sa kushton zgjerimi?", ndërsa takimi në Maliq te pyetja "çfarë përfiton Maliqi dhe çfarë duhet të garantohet që të mos humbasë?"Kjo e bën konsultimin më neutral dhe më të besueshëm, sepse nuk e paraqet konsolidimin si një rezultat të paracaktuar, por i jep komunitetit mundësinë të vlerësojë përfitimet, kostot dhe kushtet e nevojshme për një konsolidim të suksesshëm.

Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi; Kjo nuk është dëgjesë. Të paktën ta dimë, edhe të mos bëjmë sikur bëjmë një dëgjesë. Është të gënjejmë veten. Dhe mos i merrni gjërat, sepse politikës, kushdo qoftë, majtas apo djathtas, ju intereson që ai t'i shkrijë ne, t'i përzërë njerëzit. Kurse ne do ta vuajmë. Këtë e mbani mend. Dhe unë ju jap një mesazh: unë jam banor i Libonikut, jam qytetar si ju, dhe sot jam në këshill, nesër do të bëhem zgjedhje. Jam apo s'jam, unë apo një tjetër, nuk ka rëndësi. Flas edhe për ekzekutivin. Nuk ka rëndësi se është ky djali në punë apo është ai. Këtu ka rëndësi që pyetja shtrohet fare e thjeshtë: ne, o qytetarë të bashkisë së Maliqit, të Libonikut, të gjithë zonës që kemi sot këtë gjoja dëgjesë, që nuk është dëgjesë për mua, sepse ka mungesë të këshilltarëve, ka mungesë të kryepleqve, ka mungesë të njerëzve të shumtë. Do të thotë njeri që nuk i detyrojmë dot. Nuk i detyrojmë, ore, por unë i dëgjoj për lokale, thonë, rrinë për lokalet... Po të ishte një mbledhje partie, shtroj pyetjen. Të vinte dikush, a të vinte Edi Rama? Do ishte bërë këtu nami. Pse të mos bëjnë për hallin e tyre? Kjo më shqetëson mua. Se edhe unë, tek e fundit që flas këtu, mund ta kem më mirë se dikush që është fukara këtu. Iki nesër unë edhe... A e kemi fituar gjë? Prandaj, vëllezër e motrat e mia, ejani të bëhemi bashkë, të mos e lejojmë të humbasë kjo bashkia. Nuk ka rëndësi se sot është gëzimi, nesër do jetë ninja, do jetë çupa, apo të jetë... epo të jetë. E rëndësishme është që ne na largohet shërbimi. Unë nuk kam më keq me Korçën. Unë në Korçë rri përdita. Më mirë do ta kem si vazhdim. Po ai që do vijë nga Dushari? Po ai që do vijë nga Zareci? Do vetë të lejë në hotel. Për një leje, për një diçka. Duhet ta humbasim këtë? Këtë që kemi ngritur? Ne e ngritëm edhe institucionin. Ne kemi bërë thashë të rregullohet edhe kjo. Kemi bërë bashkim për mrekulli. Institucionin. Kemi bërë gjëra shumë të bukura. Po, po nuk të denjë ti njeri në shtëpi, shtëpia është shkatërruar. Edhe kjo. Po lëre tani se do bëjmë kështu, po do bëjmë kështu. Këto janë. Prandaj, edhe një gjë do t'ju them me shpirt e me zemër: mos ndiqni më politikën për hallet tuaja. As Asdiun, as këdo që të jetë. Mos e ndiqni as Edi Rrahmën, as Ilir Metin që është në burg, as këdo. Ndiqni vetveten. Kaq po ju them. Ndiqni vetveten, se do ta pësoni dhe do thoni "ç'na ndodhi". Si një fatkeqësi kur bie. Dhe kjo është fatkeqësi në qoftë se do shkrihet bashkia e Maliqit. Prandaj, më falni, prandaj do t'ju lutem shumë. Ne i kërkuam si këshilltarë. Dhe i kemi iniciatorë ne të këshillit që e bëjmë këtë. Dhe opozita, po doni ta dini, unë edhe atë ditë që e pashë

që isha në protestë, e pashë në rrjete, nuk më lajmëroi asgjë kurrë. Dhe nuk dua t'i jap ngjyra politike për ata vasalitomor, po flas. Po dua që të bëhet një gjë: që juve të ndiheni nesër, flas për ata djemtë e rinj, flas për fëmijët. Se po e mbyll këtu, do shkretë komisariati, do mbyllet shkolla, do ikin njerëzit, dhe këtu do të bëhet pastaj... Unë thashë një fjalë atje, s'dua ta përsëris më. Pastaj baktitë. Edhe baktitë nuk ka se po thotë si njerëz. As qen nuk ka më. Se s'kanë ku të ushqehen. Prandaj, të nderuar qytetarë, edhe një herë, po jua them me shpirt e me zemër: të bëhemi të gjithë bashkë, të mos e lejojmë këtë që është bërë projekti. Se i kanë rënë me një të shtrirë të lapsit, edhe u bëra ta shkrejnë. Për momentin u duket sikurse po thotë aty në atë projektin gjoja, që do të mbetet këtu administrata, dhe do vendosë X-in. Këto do t'u mbajë juve tempull. Jo, mor jo, mos i ngatërroni gjërat. E kam thënë dhe e them plotësisht: administrata është tjetër gjë, puna është tjetër gjë. Po ne do të mbajmë shërbimin në radhë të parë. Pastaj, të them specialistët e duhur. Jam plotësisht dakord. Mos të jenë 10 veta në një zyrë, po të jenë 3 e të bëjnë punën. Dhe mos e ngatërrojmë gjënë, se dikush më thotë edhe nëpër Facebook që, ore, thotë, "shkrejeni, thotë, të ikin këta". Nuk është kaq e thjeshtë. Nuk ka të bëjë me emra, nuk ka të bëjë me njerëz, me pozicione. Ka të bëjë me shërbim. Dhe nuk është ndërmarrje këtu që falimentojnë dhe e shkrejnë. Nuk është ndërmarrje. Keni parasysh: bashkia do shërbim përdita, se janë mbushur koshat me plehra. Do shërbim ndriçimi, do ujë, do kanalizime. Ju i dini më mirë se mua. Do bujqësi. Ah, të bëjmë politika! Si të shiten prodhimet, si të prodhohet, si të bonifikohet, si të rregullohet. Sepse jemi një bashki që i plotësojmë të gjitha kushtet për të qëndruar bashki. Çfarë i ka gjetur tjetrin e tjetrin? Një policion i vogël që... Do thoni juve, po thotë Asdiu, se do një dokument. Po do ta djegim atë dokument. Edhe babi im do e djegë zjarrin në qoftë se ka bërë gabim te varri. Ç'është kjo pikë e zezë? Tashti, njerëzit mendojnë: "hajde se do dolim çdo herë, bëjmë dëgjesën dhe u mbyll kjo". Unë po ju them, jam i gatshëm edhe si anëtar i këshillit, si qytetar, të jem në zërin tuaj për të mos e shkrirë bashkinë. Edhe atje do jap votën time kundër. Le të bëhet si të duan pastaj, por unë kam të drejtë që nesër, kur të takohem me këdo nga ju, se njëri edhe unë njoh, e do t'u njoh mirë, mos më thoni pastaj që "çfarë bëhet, çfarë është". Kaq kisha. Ju falënderoj të gjithë dhe ju prift e mbarë aty.

Banor i NJ.A Libonik:Për këtë veprim që po bëni.Administrata e pranon apo jo? Ka ndonjë mendim unik në administratën e bashkisë, komplet, me gjithë njësitë administrative?

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari:Po administrata? Përpara se të jenë administratë, janë qytetarë. Ata janë të lirë ta shprehin.

Banor i NJ.A Libonik: Po pikërisht, ata janë përfaqësuesit tonë. Ka ndonjë mendim ata?

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari:Ata janë të lirë ta shprehin mendimin e tyre.

Banor i NJ.A Libonik: Po të lirë e di unë që edhe ata janë si ne, po atje në zyrë janë tjetër gjë. Nuk janë si ne.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari:Nuk është se kemi zhvilluar ndonjë takim veçmas me administratën dhe t'i pyesim. Jo, jo.

Banor i NJ.A Libonik: E dyta: kjo dëgjesë publike ka fuqi ta ndryshojë atë projekt-draftin që ka vajtur në parlament? Se duket si e rëndë, se duket si për së mbrapti puna. Kështu, ndryshe bërë kjo, tha të vinte drafti. Tashi çka vajtur drafti, na pyesin ne për formalisht.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari:Jo, po drafti nuk është votuar.

Banor i NJ.A Libonik: Jo, nuk është votuar, por ka vajtur atje.

Banor i NJ.A Libonik z.Sazan Skëndo:Për tani? Për ne të gjithë njësinë. Donim të mbyllet, të përjashtohen shërbimet që duhet të jenë në territor, pjesa tjetër duhet të ikë. Po ne që në kohën e monizmit, në kohën e Zogut, Maliqi ka qenë lokalitet. Lokalitet do ngelet.Unë do them mendimin tim: lokalitet do jetë, nuk ka sot, nuk do bëhet ndonjë gjë e madhe. E mira tonë, e timja, timja, personale ama, të paktën të ulen ca taksat. U ngritët juve të bashkisë si këshilltarë e thatë që "ne po diskutojmë si këshill". Më thoni juve që keni kundërshtuar një herë për taksat e biznesit, t'i keni ulur në bashki. Një herë ju, të dy që jeni aty. Të dy. Ty edhe ty.Kryetar nënkryetar. Një herë, bre! Po si jo, paguaj taksa 1. 5 milion lekë në vit, taksa, akoma doni të më rrini këtu? Për mendimin tim të shkrihet bashkia Maliq dhe të bashkohet me bashkinë Korçë.

Ish Administratore e NJ.A Libonik znj.Burbuqe Beshiri:Përshëndetje. Jam një qytetare e Bashkisë së Maliq. Kam marrë njoftimin nga Facebooku që do të bëhet një takim për reformën territoriale; nga 61 bashki që janë në tërë Shqipërinë, do të bëhen 46, dhe një ndër to, për të futur edhe Bashkia e Maliqit, që do të shkrihet. Puna që ka bërë Bashkia e Maliqit 10, që ka punuar fort si kryetari dhe të gjithë, është bërë investime, janë bërë plot gjëra. Megjithatë, duhet prapë të kërkojmë që te ne të bëhen investime më shumë, të jepen sa më shumë ndihma njerëzve që janë në nevojë. Atyre që vërtet janë në nevojë, duhet vërtet t'i ndihmojmë me mish e me shpirt, si administrata, edhe nga këshilli, dhe të gjitha. Njëkohësisht, investimet, edhe nëse është bërë projekt dhe do të realizohet, se atë e vendos parlamenti, ne kemi mendimin tonë: duhet që në Bashkinë e Maliqit të sillen investime më të shumta, dhe të mbetet që çdo gjë të administrohet në Bashkinë e Maliqit, ose çfarë do të mbetet në të ardhmen. Mendimin tjetër kam që duhet, sepse ne jemi një mos i qeshët ndonjëherë, se unë s'po them ndonjë për të qeshur, duhet më tepër të bëhen investime sa i përket bujqësisë, sepse bujqësia në zonën tonë ka një zhvillim më të madh se në të gjithë fshatrat e tjerë, dhe ne në fshatin tonë nuk kemi plotësisht ujë për të vaditur.Se të gjithë, që të rritet mirëqenia. Duam më tepër investime, duam më tepër vëmendje ndaj qytetarëve, që edhe ashtu, në qoftë se do të bëhet bashki e madhe, të kemi rezultat. Të ketë rezultat, se ashtu u fillua edhe me bashkitë, kur u shtri bash ajo komunat dhe u bë një sjell administrative, u bë Bashkia e Malikit. Gjithmonë ka një fillim. Megjithatë, ne duhet përsëri, gjithmonë, të kërkojmë që të vijnë investime pranë qytetarëve tanë, pranë njerëzve tanë që janë në nevojë. Unë kaq kisha. Ju faleminderit.

Banor i NJ.A Libonik: Po, para se të bëhej këtu, u bë një dëgjesë publike më e madhe se kjo. Edhe në dijeninë time, nuk di pse tha dikush nga Bashkia e Malvishit që të jetë shprehur pro shkrirjes së bashkisë. Edhe për aq kohë sa në atë dëgjesa nuk doli dikush që të shprehte mendimet e kundërt, si ka mundësi që u bë e kundërta e asaj që banorët thanë? Edhe mbi ç'bazë u përzgjodh Maliqi për t'u shkrirë si bashkim? Unë jam kundra shkirijes në mënyrë kategorike.

Administratore e NJ.A Libonik znj.Rudina Bregu I dëgjova me shumë kujdes dhe shumë po e përpunoj atë që kam dëgjuar. Ju, me shumë të drejtë, i ngrini këto pyetje, por as përfaqësuesit e këshillit, as unë, as... nuk jemi ne komisioni që kanë përcaktuar kriteret. Ne mund t'i kemi lexuar të gjithë diku, por nuk i kemi vendosur ne ato kritere, prandaj edhe nuk mund t'ju themi dhe dot, nuk mund t'ju shpjegojmë dot, përveçse me logjikën tonë, por saktësisht se çfarë kanë diskutuar ata që janë marrë me reformën. Unë, si administratore e njësisë administrative "Libonik", patjetër që ky diskutimi për reformën... unë e kam shprehur dhe po e shpreh edhe këtu, që nuk lidhet as me arsye personale, as me. .. as për karrigen time, as për. .. as për arsye politike, as për gjë. Unë, ajo që është e rëndësishme, dhe do këmbëngul ta them kudo që... për sa do më dëgjohet fjala, unë patjetër që jam me qytetarët. Ne e dimë shumë mirë, duke pasur edhe punë përditë me komunitetin dhe duke i takuar përditë, duke qenë përditë në terren, e dimë se sa nevojë kanë ata që të marrin shërbimin në kohë sa më të shkurtër, të zgjidhet... domethënë, ai problem kur ata trokasin, të zgjidhet në mënyrë të menjëhershme dhe të mos ketë sorollatje. Kështu që unë, ajo çfarë kërkoj nga reforma, qoftë çfarëdo. .. çfarëdo vendimi që të merret, ajo që unë kërkoj është që kjo reformë të ketë... të marrë parasysh edhe... të këmbëngulin edhe ata që do ta zbatojnë, qoftë pro ose kundër, që të kenë prioritet qytetarët. Domethënë, të kenë parasysh që shërbimet t'u jepen qytetarëve, që kjo bashki, qoftë bashki, qoftë njësi, çfarëdo që të mbetet, të ketë një buxhet të dedikuar, të ketë një nënkryetar të dedikuar i cili të ketë mundësi që këto punë të mira që janë bërë deri tani të vazhdojnë, të vazhdojnë investimet që janë bërë, të mos mbeten përgjysmë, por të paktën të përmirësohet. Domethënë, dua që reforma të ketë përmirësim, jo të çojë në degradim apo të harrohen ato që janë bërë. Çdo investim, i nisur deri në këtë moment, çdo projekt, të vazhdojë, të çohet deri në fund, por edhe të ketë edhe më shumë investime.

Banor i NJ.A Libonik: Tema është për shkrijen e bashkisë Maliq? Unë jam kategorikish kundra, sepse nuk kemi mundësi neve, janë gjithë ato fshatra dhe ne nuk na realizohen të gjitha që kërkojmë, jo të shkrihet dhe të bashkohet me Korçën, që ne nuk do kemi asnjë rrugës zgjidhje. Unë jam kategorikish kundra me gjithë burrin tim, me gjithë fëmijët e mi, që të mos shkrihet.Po të jetë mundësia dal dhe në protestë për këtë gjë.Kryetari i bashkisë Maliq, është një njeri i ndershëm dhe ka punuar shumë për këtë vend, faktet flasin si ka bërë pallatet, si e ka bërë pjesën poshtë.Që sihte kënetë.Unë kam vetë diçka, të na ndihmoni ju të bashkisë për kanalzimet.Kaq kisha unë faleminderit.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari:Faleminderit! Kemi diçka tjetër? Ditë mbarë.

Mbajtës Protokolli!

Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

SEKRETARI I KËSHILLIT

Datë 14.08.2026

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 14.08.2026, në konsultimin Publik, në ambjentet e NJ.A Pirg Projektligji: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë.
ora 10:00.

Të pranishëm:Këshilltar:z.Petrit Kupe; Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi;Sekretari i Këshillit:Gertjan Gjiriti; Adminitratori e NJ.A Pirg z.Ermal Gjona; Kryetarë fshatrash; banorë të NJ.A Pirg sipas listës bashkangjitur.

Këshilltar:z.Petrit Kupe: Falënderuar për pjesëmarrjen në këtë dëgjesë publike. Do të ishte më mirë që pjesëmarrja të ishte akoma më e madhe, me banorë të njësisë administrative, por vemë re që një pjesë përfaqësohet nëpërmjet kryetarëve të fshatrave. Siç e dini, Kuvendi i Shqipërisë i është dërguar, i është drejtuar bashkisë, bashkisë Maliqit, që është një nga bashkitë që mund të bashkohet me bashkinë e Korçës, për të organizuar dëgjesa publike me komunitetin. Kjo është në përputhje me nenin 89 dhe 90 të ligjit 139/2015 për vetëqeverisje vendore, dhe kërkohet që kryetari i bashkisë të paraqesë mendim të tij zyrtar, duke argumentuar mbi propozimin e bashkangjitur. Këshilli i bashkiak të shqyrtojë propozimin në mbledhje dhe të miratojë mendimin e tij zyrtar, pra mendimin e tij zyrtar, duke pasqyruar në aktin përkatës dhe qëndrimet kundër ose alternativës, nëse ka. Bashkia të organizojë informim dhe konsultim të popullatës në territorin e saj nëpërmjet dëgjesave publike, në njësitë administrative, takimet me banorët dhe instrumentet e tjera të përshtatshme, si dhe të përmbledhë dhe të përcjellë zyrtarisht mendimet e popullatës. Për organizimin e dëgjesave është lënë një periudhë 60-ditore përpara se propozimi i drejtuar Kuvendit të miratohet në Kuvend. Edhe ky është një nga takimet që po organizohet edhe nga ana e Këshillit për të dëgjuar mendimet e përfaqësuesve të komunitetit apo të banorëve për këtë propozim të bërë. Pra, siç e dini, jeni të qartë që është propozuar që bashkia e Maliqit të bashkohet, jo të shkrihet, nuk bëhet fjalë për shkrirje, të bashkohet me bashkinë e Korçës. Kjo në bazë të disa argumentave të cilët ka paraqitur Komisioni për Reformën Administrative të Territorialeve. Ju pak a shumë jeni në dijeni sepse është një çështje e ditës, një çështje që diskutohet kudo, diskutohet në shtëpitë tona, në ambientet tona, në lidhje me këtë propozim të bërë. Kështu që ju në këtë takim të shprehni mendimet tuaja të hapura. Jo, ne kemi ardhur të dëgjojmë mendimet tuaja për këtë problem që është shtruar sot në zgjidhje. Unë jam përfaqësuesi i Këshillit të Bashkisë, këshilltar i Komisionit të Ligjeve dhe kryetar i Komisionit të Financës. Kemi përfaqësuesin e opozitës, pasdhjellë, nënkryetarin e Këshillit të Bashkisë, si dhe sekretarin e Këshillit. Mendimet tuaja do të

protokollohen dhe do të përcillen në Këshillin e Bashkisë për të marrë mendimin përfundimtar në lidhje me këtë çështje. Faleminderit.

Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi; Kur të bësh një veprim, duhet të ndihesh në rirsitë dhe në anomali nga që nuk sjell. Çfarë krime ka dhe çfarë pasojash? Tashti, në radhë të parë, bashkia është shërbim, në shërbim të juve dhe atyre që s'janë këtu, të gjithë komunitetit tonë. Dhe po t'i biesh hollë-hollu—prandaj ne duam mendimet tuaja, peshën tuaj, zërin tuaj—që kjo punë të mos ndodhë. Pse? Sepse dal se të digja kjo. Çfarë të mira ka? Përkundrazi, për mua, zero të mirë nuk ka, sepse largohet shërbimi. Që nga ana e anës, po të vish te Korça, do të thuhet: "Dikush më thoshte që ka ndryshuar koha, se jemi në internet. " Ç'është ky internet? Ti nuk di ta bësh, unë s'di ta bëj. Mund të vijë ai djali atje me atë anë?Ne kështu nuk i kemi zgjidhur kërkesat. Ne jemi kaq e thatë, shumë bukur, juve këtu, që kur e kishim drejtorin—se e kam në krah, nuk dua të jetë ashtu, kam respekt edhe si njeri—ishte këtu, po i trokisja më shpesh. Tani s'po gjejmë atë inxhinierin që thoshin ata dje, pak vjet më parë, burimat, si thoshin atij djalit. Na ka dërguar final, na ka dhënë numrat. Prandaj, pyetja është me vend dhe nuk ka, po e them këtë me shpirt, nuk ka asnjë risi të mirë që këta munden të po merren me lapsin. Prandaj kjo do dëgjësë: a ka mundësi të bëhet refundum popullor? Po. Ne duhet të jemi refundum shqiptar. Kur janë gjëra madhore që duhet t'i shërbejnë atdheut, duhet të kalohet në refundum shqiptar. Kjo do të jetë gjëja më e bukur.Faleminderit.

Kryetar i fshatit Novoselë NJ.A Pirg z.Maksim Muçollari: Arsyeja pse duhet të bashkohemi? Sepse ne nuk jemi ndonjë bashki e vogël, jemi pothuajse e 18-ta në Shqipëri, kemi 38. 000 banorë. Përse duhet të bashkohemi me Korçën? Por Korça është më e vogël pa ne.

Këshilltar:z.Petrit Kupe: Komisioni ka përcaktuar një seri kriteresh të performancës dhe është mbështetur në to: në territorin, në qëndrueshmërinë ekonomike, në diversitetin e zhvillimit, apo edhe në mos-përballim dhe financimin. Dhe është menduar që bashkia e Maliqit të përfshihet në 50 bashkitë që mendohet që të bashkohen.

Banor i NJ.A Pirg:Të thuash që Bashkia e Maliqit është me performancë të dobët, kësaj i thonë që "haj ta bëjmë kështu se kështu do bëhet". Se Bashkia e Maliqit nuk është me performancë të dobët. Një. Dhe e dyta, në qoftë se ka nevojë për të shkrirë, shkrihet, mund të shkrihet shumë mirë. Erseka që nuk ka as territor dhe as kapacitetin e Bashkisë Maliqe. Kështu që, të thuash "shkriu Maliqit" i bie që themi: do bëhet, haj ta bëjmë, se kështu është reforma. Reforma, por reforma për mua nuk është bërë siç duhet.

Këshilltar:z.Petrit Kupe: Pra ti kundërshton.

Banor i NJ.A Pirg:Për mua janë komplet kundër.

Kryetar i fshatit Çaushli NJ.A Pirg z.Lulëzim Krasta: Edhe këtu në moment që ne po flasim kryetarit tonë është, kurse puna e Mori Kosha, ne çfarë? Më ka thënë kot. Jam i mendimit që mos ta shkojmë. Ajo është në terren, nga është 24 orë në punë non-stop, dhe 1 orë nuk po ia rrin dot asaj që të bëhet, të mendon ajo. Si do ta arrijë ai tjetri që nga zyra, apo si qytet? Dhe ai të dalin 3

herë pasdite, po s'e gjetën në terren atë kryetarin, ne mua të më shtyjnë të gjithë. Edhe nuk ia arrijnë dot prapë. Si do na arrijë Korça neve? Jam kundra bashkimit.

Kryetar i fshatit Velitërnë NJ.A Pirg z.Syrja Hamzallari: Po. Jam kundra bashkimit, bashkimit të dy bashkive. Për ato jam arsyetues që tha edhe shoku, ndoshta. Ndoshta. E papranushme. Në një kohë tjetër mund të rriten njerëzit dhe ndoshta mund të rriten, por për momentin është e papranueshme. Dhe nuk e pranojmë asnjë nga— Dhe kemi një konsultuar me njerëz, me fshatarë, dhe është e papranueshme. Arsyet nuk e di. Preferenca për mua s'është e vërtetë, sepse unë di që bashkia—shyqyr që mori një radhë të mirë—që në fillim, kur u bë reforma e parë, ne e kundërshtuam. E vërtetë e madhe ishte bashkia e parë. Megjithatë, ndoshta drejtimi i bashkisë, apo e të tjerën, erdhi në atë fazë që ne jemi—e kemi marrë veten, pak a shumë.Dhe nuk kemi prokurorë të dobët, por përkundrazi, ka rezultat. Sepse vështirësitë e kësaj bashkie nuk kanë asnjë bashkëkuptim. Është fejësisht kursore, detyre, kështu që ka vështirësi kështu. Dhe për këtë mëngjes, që ju vazhdu me— Shumë keq, Petrit, jemi shokë të vjetër. Mua më duket se është kohë. Është shumë e vonë. Ç'do me thënë kjo, tashi, të shpillet drafti në parlament dhe pastaj të vish të dëgjosh gjendjen çfarë do bëhen.Unë nuk e di, nuk e di. Po ata specialistët që kanë bërë, nuk e di se kush e kanë bërë. I shohim kështu, po. E di çfarë mendimi kam unë. Ku jam nisur që këto duhet të bashkohen. Unë nuk jam me atë që tha Petrit, se doja seka ca probleme të tij. Edhe seka s'pranon një gjë të tillë, se ka gjëra të tjera, për niveli i lartë, Për mua është e papranueshme. Bashkimi, dy bashkive. Ky është opinioni në përgjithësi i bashkëfshatarëve të mi. Dhe sot, ndoshta, pjesëmarrja është e ulët. Pjesëmarrja është e ulët, sepse janë të thellë në punë.

Banor i NJ.A Pirg: Edhe unë si qytetar i kësaj bashkie, jam 100% kundër. Nuk e kuptoj si ka mundësi që partia tonë në pushtet të marrë këtë nismë për të shkrirë bashkinë, për të shpërpulluar këtë vend. 15 bashki t'i shpërpullosh do të thotë të jesh i hapur vendit të vijë parliamenti. Këta për një gjë tjetër. Dhe ky është gabim i mirë rendi që po bëhet. Dhe unë s'kam çfarë të them tjetër.

Banor i NJ.A Pirg ish-Kryetar Komune z.Tefik Meçollari: Koncepti im është ky: që sa më i vogël të jetë punimi, sa më afër të jetë shërbimi, aq më efikas është. Dhe kjo është vërtetuar. Sa më të mëdhaja të jenë pritësitë administrative, më larg shërbimi qytetar i trashëgim. Unë mund ta kem gabim, por praktika është kështu. Këtë e kam vërtetuar, këtë e kam vërtetuar. Ishte komunë, shkoi, u zmadhua. Tashi, po zmadhohet prapë, vetëm largohet shërbimi dhe krijohet një inert në mes të institucioneve. Kjo është e para. E dyta, unë të them të drejtën, isha me dy mendje: vija apo s'vinja, sepse më duket kot. Pse? E argumentoj. U bënë dëgjestat e para, u mbyll komisioni, u bënë dëgjestat. Në korrekt, u bënë me ato pjesëmarrje, nuk e di, por nuk ma bën mendja. Edhe nga informacionet e mediave që kemi, e të tjera, edhe biseda kështu, nuk është shprehur elektorati ose publiku, nuk është shprehur që duhet të bashkohet. Ose, bile përkundrazi, më duket se anon nga ajo që duhet të jetë më afër, më e vogël mundësia për ato shërbime. U mblodh, bënë draftin, e nisën. Tashi, kthehemi te dëgjestat e dyta që ia kanë lënë këshillit të bashkive. Me të informuar. Këshilli i bashkisë, tashi, ju po bëni detyrën tuaj, erdhët këtu, do merrni dëgjestat, po i shkruani po i bëni, do t'ia shkruani. Do bëni një raport të këshillit, do ta nisni. Një mendim. Në parlament dihet. Pra, është e mbyllur. Atëherë, pse bëhen këto gjeste? Unë kam një praktikë, e do kërkoj falje, do të bëj një zgjatje. Nga 65-66, në vitin e kaluar, është kërkuar që pirgu të kalonte në Pogradec. Dhe u bënë letra, nuk e di çfarë ishte bërë, dhe u bë problem. Është mbledhur populli këtu që u mor mendimi: që të shkojmë në Pogradecin apo të qëndrojmë në Korçë. Unë kam qenë

i vogël atëherë, dhe u mblodhëm, e mbaj mend, u mblodhë këtu, që u pyet, erdhën nga strukturat e partisë, nga këshillit të vetar, u mblodhëm. Do shkojmë në Pogradecin siç kërkojnë disa, apo do qëndrojmë në Korçë? Do qëndrojmë në Korçë. Pra, pyetet populli. Po, pa u pyetur. Dhe tjetra që kam, që dua ta ashtu, përqendrimi i... meqë jemi këtu, se s'ka të bëjë shumë me atë, por përsëri është në funksion të shërbimit dhe në funksion të pushtetit lokal. Përqendrimi i kompetencave drejt qendrës. Gjithmonë: bëj ndryshime, merr kompetenca. Bëj ndryshime, merr kompetenca. Dhe ky burrë që ua këtu, më falni për shprehjen, është kryeplaku i fshatit. Pyetje e rikthe: ky s'ka asnjë të drejtë.

Banor i NJ.A Pirg: Tashti, kjo reforma territoriale që prek bashkinë e Maliqit, çfarë kriteresh ka, dmth, nga ata që kanë prekur reformën, që një bashki duhet t'i bashkëngjitet një bashkie tjetër? Për shembull, ne jemi një bashki e madhe. Bashkia thonë: "Aq e madhe sa është? " Në qarkun e Korçës, mendimi im, duhet të jetë e treta nga numri i popullsisë. Po mirë mo, ne jemi 6 bashki këtu. Po nuk kishte një bashki më të vogël për ta hequr, e tjetra? Unë e kundërshtoj këtë. Qëllimi është se neve ujësjellësin e kemi dhënë Korçës, dhe kur e kishte bashkia, kishim 2 orë ujë. Tash kemi vetëm një. Nuk lag dot sytë në treg. Te nuk kemi ujë, nuk kemi. Hajde ta gjejmë atë nga Korça, ne të marrim atë në telefon e të vijë ai të rregullojë atë pusetën aty. Kështu që mendimi im është ndryshe. Ne nuk do të pranojmë në asnjë mënyrë që të bashkohet bashkia e Maliqit me Korçën. Në asnjë mënyrë. Pastaj, a na pyesin a s'na pyesin ne këtë a e dimë? Po mirë është që ne kemi aq njerëz sa të qëndrojnë bashki. I thonë 30 deri në 1000 e ca më duket. Kemi. Një territor shumë të madh. Bashkia e Maliqit është një bashki bujqësore. Dhe është gjynah që ne të ikim, që nga Maliqi të ikim në Korçë. Pastaj lej vështirësitë e dokumentave e të tjerat e tjera që i dimë ne. Kaq kisha. Unë faleminderit.

Kryetar i fshatit Novoselë NJ.A Pirg z.Maksim Muçollari: Po, kryetar i fshatit në Novoselë. Unë jam kundër, por shumë kundër. Si bashkimi në Korçën, për shumë arsye. Arsyeja. Një arsye se ka 100 milionë arsye. Arsyeja? Ta po e centralizojmë drejtimin vetëm në një njeri. Duke hequr— ja, kemi edhe administrator— po është administrator që e vendos kryetari. Po të thotë kundër kryetarit, e heq kryetari. Tash ti do jesh i atij Filos. Po të zesh ai, të heq. Këta s'duan asnjëri të zgjedhur. Se njeriu i zgjedhur mban qëndrim dhe jep të drejtën. Atje ku duhet. Atje ku duhet, brenda ligjit. Dhe brenda ligjit asnjeri s'ja mban. Kjo është gjëja më e keqe që po ndodh. Në Maliq u krijua një bashki dhe u krijuan ca biznese, u krijuan shumë gjëra që këta njerëz të mblidhshin, e njerëzit investuan. Por e njerëzit investuan atje. Tash çdo njeri që pati 2 lekë ai investoi. Tash do bëhet vendi i shkretë, si Pirgu. Ne Pirgu vijmë vetëm kur na thërret ndonjëherë Mali, edhe shyqyr që bëhet njëherë pazari. E pazari do prishet tash. Që mblidhemi ne, që të pimë kafe. Pa le pasar për shërbime, as që bëhet fjalë të diskutohet. Ne këtu e njohim Gëzimin, e kemi shok, edhe është njeriu më punëtor. Le të duan, le mos e duan, kush të dojë. Është njeriu më punëtor që ekziston. Dhe prapë nuk i arrin dot. Janë 84 fshatra. Ti mendosh, lodhesh. Jo, t'u zgjidhësh. Kur ju dalin probleme. Përditë. Përditë dalin probleme. Ti je kryeplake, kur del në mëngjes të gjesh njerëzit e zënë. Po edhe ne na i kanë hequr të tjera. Mos e dini se ne quhemi kot kryepleq, se ne vetëm për zjarret kemi të drejtë të vendosim. As për gjithë tjetër. Edhe për drogën që— po të dali drogë, të hyjnë burg në emocionata. Kaq. Prandaj jam absolutisht kundër. Dhe duhet të jenë të gjithë kundër. Se prishet nga mendja e nuk duhet të prishet nga termat. Duhet bile edhe që ata thonë do rrinë te administrative. Pse duhet të rrijë i pazgjedhur ky? Nuk votojmë dot ne? Ky që do jetë këtu. Mirë, dakord. Edhe ai, le të quhet qendra e administrative, të votojë. Të votojë, mo. Jo ta caktojë ai. Se

po e caktove, nuk ke asgjë, mo. E di çfarë je? As brigadier nuk je i fortë këto. Se edhe brigadieri merrte vendime. I hynte këtej ose i hynte andej. Nuk ke asgjë. Të dërgonin te dushka ju do.

Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi: Tashti.Si shumë pyetje, shumë zëra të fuqishëm, shumë zëra realë që unë dëgjova në këtë mbledhje administrative. Këtu. Është një e vërtetë: ky bashkim me Korçën është një diskriminim që mund t'i bëhet gjithë komunitetit. Dhe, shumë e vërtetë, që është kapja e pushtetit në një dorë dhe kapja e kësaj dije, se kush është ai i madhi atje lart, që t'i shkrijë të gjitha këto vjeta. Këtë po jua them ta dini shumë mirë. Dhe unë them kështu: edhe opozita, edhe populli, edhe pozita që është sot, duhet të mos e lejojë kurrë këtë katastrofë që po ndodhi. Se unë dua ta afroj djalin në Shqipëri, e jo të rrijë në Amerikë. Dua ta afroj, e jo të iki fare nga sytë e këndit. Po kjo bëhet me shërbime. Shërbimet humbasin dhe nuk fitojmë asgjë. Ne do të çojmë mandatet pastaj Korçës, Korça do vejë atje, të falemi atje, për çdo dokument. Kjo për ne, dhe unë jap një mendim kështu. Juve më pëlqeni shumë. Me mendimet që dhatë, populli të çohet në këmbë për këtë histori, në qoftë se do të preket bashkia e Maliqit. Dhe janë 400 prish dhe opozita për t'i shtuar bashkitë. A ka mundësi të bëhen 3 brenda bashkisë së Maliqit? Një po ja, një Pirg, edhe atje tjetër. Që shërbimi të shkojë sa më i kulluar dhe sa më i pastër tek qytetarët. Prandaj, e thashë këtë dhe po e them: ne mendime dhamë, ne mendimet tuaja do t'i sugjerojmë në këshill. Dhe unë jam për referendum. Në qoftë se nuk pranon Republika e Shqipërisë për referendum, që do të ishte akoma më e madhe, se është problem madhor, ne si njësi, ose si bashki, të dalim me referendum, të votojmë: jeni dakord ta shkrimë bashkinë? Po ose jo? Ta vendosë populli, dhe atëherë le të kemi qafë secili vetveten. Ju faleminderit që më dëgjuat, dhe kjo është.

Këshilltar:z.Petrit Kupe: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? Ditë mbarë.

Mbajtës Protokolli!

Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

SEKRETARI I KËSHILLIT

Datë 18.08.2026

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 18.08.2026, në konsultimin Publik, në sallën e Këshillit Bashkiak Maliq Projektligji: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë. ora 11:00.

Të pranishëm:Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari;Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu; Sekretari i Këshillit:Gertjan Gjiriti; Këshilltarët:z.Pranvera Begolli; Adminitrata e Bashkisë Maliq; Kryetarë fshatrash; banorë të qytetit të Maliqit; Përfaqësues të shoqërisë civlile; biznezit, medias; sipas listës bashkangjitur.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari: Mirë. Mirëdita të gjithëve dhe faleminderit që po merrni pjesë në këtë takim. Është një takim që organizohet nga Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim me bashkinë, me ekzekutivin, dhe ka për qëllim marrjen e mendimeve të qytetarëve në lidhje me reformën administrative territoriale, e cila do të zbatohet vitin e ardhshëm në vendin tonë, në Republikën e Shqipërisë. Viti i ardhshëm përkon me zgjedhjet e radhës të pushtetit vendor dhe është menduar që vendi ynë të ketë një hartë të re administrative territoriale. Para 7-8 muajsh, në fillim të vitit, u krijua një komision parlamentar për rishikimin e reformës territoriale në Republikën e Shqipërisë, dhe në krye të 7-8 muajve—thashë edhe një herë, më falni nëse gaboj për periudhën—në krye të 7-8 muajve, komisioni i ngritur për reformën prodhoi një produkt, nxori një draft-propozim, të cilin e ka paraqitur në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë për votim, për miratim. Tani, draft-propozimi parashikon që nga 61 bashki të shkojnë në 46, pra Republika e Shqipërisë të administrohet, të organizohet në 46 bashki. Që do të thotë: 15 bashki do të bashkohen me bashki të tjera pranë territoreve të tyre. Midis këtyre 15 bashkive është edhe bashkia jonë, Bashkia e Maliqit. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pasi u njoh me draftin e komisionit, i përcolli projektligjin bashkë me një letër shoqëruese nëpër njësitë vendore, pranë këshillave bashkiake dhe pranë bashkive, me qëllim që këshillat bashkiakë të shprehin mendimet e tyre në lidhje me këtë gjë. Tani, Këshilli nga ana e vet dhe bashkia, përpara se të marrë një vendim, vendosi që të konsultohet me qytetarët, të marrë mendimin e tyre përpara se të shprehet, dhe mendimi i Këshillit të kthehet në dokument dhe t'i përcillet pastaj Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Për këtë qëllim kemi organizuar këtë takim sot. Është i gjashti, në fakt, se kemi qenë edhe në njësitë e tjera administrative. Sot jemi këtu në qendër dhe duam mendimet tuaja në lidhje me këtë gjë. Do t'ia jap fjalën kryetarit, pastaj secili ka të drejtën e fjalës për të shprehur mendimin e vet në lidhje me këtë temë. Faleminderit, kryetar. Urdhëro.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu: Mirëdita të gjithëve. Në fakt, është një takim i rëndësishëm. Po ta keni vënë re, unë nuk është se jam shprehur shumë në lidhje me këtë problematikë. Si kryetar

i bashkisë, kam marrë pjesë në një dëgjesë në komisionin parlamentar, i cili është marrë me reformën territoriale, ku kam shprehur idenë time, mendimin time, për reformën e vitit 2014-2015 si një reformë e suksesshme, në konceptin tim, patjetër. Dhe aty kam dhënë argumentat e mia në komision për atë çfarë ne si pushtet lokal kemi arritur në këtë periudhë gati 12-vjeçare. Unë i qëndroj ende idesë time që reforma e re territoriale e vitit 2014 ka qenë e suksesshme, jo se s'ka patur problematika gjithmonë ka problematika por Maliqi, njësitë administrative, pothuajse kanë pësuar një ndryshim të madh krahasimisht me atë që kishin ish-komunat. Dhe mua më vjen mirë edhe kur dëgjoj, kur shikoj, apo kur dëgjoj dëgjesa që ndodhin në njësitë administrative që thonë: Të qëndrojmë, nuk jemi për shkrirjen e bashkisë, nuk jemi për bashkimin e bashkisë me Korçën, pasi në një farë mënyre janë dhe vlerësim për punën tonë të deritanishme. Por nga ana ligjore, ne kemi të drejtë, kemi detyrim për t'u shprehur, edhe dy janë institucionet që duhet të shprehen për këtë qëllim: është Këshilli Bashkiak, i cili organizon dëgjesa siç është kjo e sotmja, edhe Kryetari i Bashkisë si organ ekzekutiv që duhet të shprehet për atë çfarë ai mendon për këtë reformë. Pozicioni jonë është pozicion edhe administrativ, edhe politik, se minimalisht unë si kryetar bashkie përfaqësoj, më ka propozuar një subjekt politik, i cili ka propozuar dhe ndryshimet për të cilat Kryetari i Këshillit foli më herët. Por që ta them që në fillim, ende unë jam i paqartë për atë çfarë do të ndodhë, në kuptimin e çfarë do të ndryshojë në qoftë se do të miratohet kjo reformë e re, cila do të jetë statusi i qyteteve tona, i bashkive tona, i kompetencave, i financave, i investimeve. Problematikat janë të gjera, edhe pavarësisht kjo nuk mund të thuhet me një "po" e me një "jo". E kur unë këtë e kam si merak në vetvete, llogarit si mund ta kenë qytetarët, si mund ta kenë njerëzit e thjeshtë për atë që shikojnë. Nga ana tjetër, më vjen mirë që edhe opozita është pro apo është kundra bashkimit apo shkrirjes, që do të thotë jep dhe ajo një plus për punën tonë. Dhe kjo është për t'u ndjerë mirë që bashkia, institucioni, edhe me problematikat, me hallet, me ato çfarë ndodhin në territor, paska punuar mirë. Megjithatë, vizioni, vizioni që qeveria, vizioni që parlamenti, vizioni që institucionet po shikojnë, ndoshta e shikojnë në një prizëm tjetër, që në fakt projektvendimi e thotë me nocione, me fjali, por nuk e shtjellon, pasi kjo reformë nuk kërkon vetëm një ndryshim ligjor për efekt të asaj çfarë fola me këtë projektligj, i cili ka shkuar në parlament, por kërkon ndryshime të tjera ligjore, në ligjin e pushtetit vendor, në financat vendore, në kompetencat që duhet të kenë qytetet, pasi flitet për 15 qytete dhe nuk janë pak. E midis tyre, Maliqi edhe Divjaka janë dy qytete goxha me peshë, me një popullsi të konsiderueshme, që vetëm me censusin e fundit, Maliqi ka rreth 31 mijë banorë nga 65 mijë e kusur që ka në gjendjen civile. Që do të thotë që flasim për një komunitet goxha të gjerë, me një bashki, me një shtrirje goxha të madhe, edhe të gjitha këto unë tashmë jam duke i përgatitur për t'i çuar një material Kuvendit të Shqipërisë me të gjitha ato çfarë unë mendoj për këtë reformë administrative. Nuk është kaq e thjeshtë. Mua më kanë pyetur qytetarë të ndryshëm, media të ndryshme, rrjete sociale të ndryshme, "cili është mendimi juaj? " Edhe unë e kam thënë, unë e kam shprehur njëherë mendimin tim që në komisionin, në grupin, në komisionin parlamentar, i cili në atë moment nuk është se kishte hedhur ide për bashkime, për shkrirje e tjera e tjera, por flitej vetëm në parim mbi reformat. Dhe më kanë pyetur "si ke? " dhe unë patjetër që kam qenë kundra shkrirjes apo bashkimit të bashkisë, se ka dy nocione. Nocioni që materiali vjen në projektligj nuk është shkrirje, por është bashkim dhe ka nxjerrë një nocion tjetër, që të jem i saktë edhe me projektligjin. Projektligji i propozuar parashikon që bashkia Maliq të bashkohet me bashkinë Korçë dhe organizimi i brendshëm propozohet të kalojë nga bashki në njësi administrative, që jemi sot, në bashki-qytet në njësi administrative. Domethënë, projektligji parashikon që qyteti i Maliqit të ketë një organizim siç e ka patur me njësitë administrative. Njësitë administrative të Maliqit nuk do të varen nga Korça,

por do të varen përsëri nga Maliqi. Nuk do të ketë kryetar bashkie, por do të ketë një zëvendës-kryetar funksional, se ndonjëherë flitet sikur ne si të themi pro, thonë e bën për veten e tij, si të themi kundra, qajnë hallin e karrikes së tyre. Për mua, nuk duhet parë bashkia, pozicioni, ky organizim si një moment që duhet të qajmë hallin e një kryetari bashkie. Unë mendoj që duhet të shikojmë sa shërbimet ndaj njerëzve vijnë më afër, sa u zgjidhen më lehtë, sa Maliqi do të ecë jo me këtë ritëm që ka ecur deri tani, por do të ecë më mirë, sa investime do të marrë më shumë, sa do t'u shërbejë qytetarëve. Domethënë, koncepti është shumë i gjerë. Ndaj dhe ajo çfarë materiali, projektligji dhe relacioni shoqërues që na ka ardhur neve Këshillit të Bashkisë, nuk jep sqarime, nuk jep hollësira shumë të mëdha mbi shërbimet që do të ndodhin në qytetin e Maliqit nëse do të ndodhë bashkimi me Korçën. Se thuhet që shërbimet do të ngelen prapë këtu. Ç'do të ndodhë me administratën dhe me sektorët, drejtoritë, të cilat sipas takimeve që ne kemi patur, se kemi patur dhe takime të tjera, unë nuk kam pse ta fsheh, jam i hapur, kemi patur diskutime në mbledhjen e fundit që kemi patur me kryeministrin. Unë i kam ngritur disa shqetësime të mia personale edhe për efekt të eksperiencës që kam në drejtim të bashkisë, në drejtim të pushtetit lokal, disa meraqe që unë kam në qoftë se kjo do të ndodhë. Meraku i parë është cilat do të jenë shërbimet që do të ndodhin në këtë qytet. Qytetarët do t'i marrin shërbimet më mirë apo më keq. Ky është momenti i parë. Momenti i dytë ka të bëjë mbi administratën e bashkisë, e cila edhe kjo ndoshta dikujt mund të thotë që "e mo, le të shkurtohen ca", dikujt i preket se edhe këto janë familje. Janë familje. Nga ana tjetër, cilat funksione, shërbime do të kryhen këtu, pasi flasim për sektorë shumë të rëndësishëm, ndonjëherë që janë më të rëndësishëm dhe se vetë bashkia e Korçës. Ujitje, kullimi, rrugët rurale, shërbimi i zjarrfikës, shërbimet e ndryshme që ne kryejmë në arsim apo në shëndetësi e të tjera, me ndërmarrjen e shërbimit publik, shumë e rëndësishme, 54 shkolla kemi ne në territor. Ky ishte momenti i dytë, i cili në një farë mënyre edhe këtu kjo ka lidhje direkt edhe me biznesin, se në Maliq të jemi të vetëdijshëm, jo vetëm administrata, por dhe qytetarët të cilët vijnë çdo ditë për të kryer një shërbim dhe ata shpenzojnë diçka, mbajnë gjallë edhe këto biznese që janë në qytet. Domethënë, kjo është e lidhur në një farë të pazgjidhshme me njëra-tjetrën. Ç'do të ndodhë me investimet të cilat në këto 12 vjet nuk kanë qenë të pakta dhe ne jemi munduar të performojmë dhe t'i japim një fytyrë tjetër, jo vetëm qytetit të Maliq, por të gjithë territorit. Dhe të gjitha këto që unë i ngrita në atë takim u dëgjuan me vëmendje dhe u kërkua që patjetër të jepen shpjegime dhe të bëhen pjesë e nismave ligjore, të cilat patjetër duhet përcaktuar statusi i qyteteve, shërbimet që do të kryhen, investimet, duhet të ketë një buxhet të dedikuar. Po s'kemi buxhetin tonë, flasim kot në kuptimin edhe këshillat bashkiakë të cilat do të kenë pjesën e tyre si pjesë e bashkisë Korçë, edhe aty do të kenë atë rëndësinë shumë të madhe për vendimmarrjet që do të ndodhin. Domethënë, për ta përmbyllur, edhe unë në një farë mënyre jam ende i paqartë për atë çfarë do të ndodhë me këtë riorganizim. Dhe në takimet që kemi patur edhe me kryetarin e këshillit dhe me anëtarë të këshillit, kemi rënë dakord që në një farë mënyre të kërkohen ende sqarime edhe informacione shtesë për ta çuar këtë në fund të një sqarimi edhe qytetar, por edhe institucional, që në fund të fundit ne të jemi të vetëdijshëm çfarë mund të marrim, një vendimmarrje, apo çfarë duhet të biem dakord se vendimmarrja pastaj i takon parlamentit të Shqipërisë. Këtë e kam si fillim, pastaj jam i gatshëm t'ju dëgjoj për pyetje edhe për përgjigje.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari: Kryetar, faleminderit. Kush e do fjalën?

Banor i qyteti të Maliqit;z.Marsel Selimas: Unë personalisht nuk flas për të tjerët, siç e citove dhe ti që the që në këto 12 vjet kemi pasur më shumë fonde, më shumë gjëra, dhe ndryshimi duket

vetë. S'është nevoja ta themi ne, jo vetëm në Maliq, nëpër fshatra, kudo. Nuk është nevoja. E dyta, në qoftë se shkrihet kjo, unë besoj me veten time, nuk do jenë të gjitha gjërat, nuk do jenë siç ishin. Taksat do jenë më të larta, do jenë si në qytetin e Korçës, dhe të gjitha shërbimet nuk do merren njëjtë. Mendoj unë. Investimet do jenë më të pakta. Ne i shikojmë shumë mirë edhe në rrugë dytësore dhe të gjitha. Jo, ne nuk duam të hyjmë në atë temë. Neve me çfarë shikojmë themi.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu: Mund t'ju shpjegoj diçka, ju lutem, ç'keni parasysh. Edhe për ta adresuar bisedën. Ne kemi një material, tani për të qenë të sinqertë, bashkia e Korçës është më e fuqishme ekonomikisht se bashkia jonë. Normale. Dhe nga analizat që janë bërë dhe që ka arritur në këtë pikë, janë bërë për një analizë e treguesve financiarë, urbanë e të tjera e të tjera. Dhe kapaciteti financiar i Maliqit është 49. 7%. Jam pjesë në Maliq. Ndjesë. Domethënë, kapaciteti financiar i bashkisë Maliq sipas treguesve që komisioni ka nxjerrë dhe Ministria e Financave ka, është në nivelin 49. 7%. Korça e ka 70. 2%. Dhe jemi të vetëdijshëm, kam shumë biznese, ka shumëTurizëm, taksa, çdo gjë. Dhe diferenca është 20. 5%. Efekti financiar që ne mund të marrim nga ky bashkim në total mund të ketë efekt pozitiv në qoftë se ajo merret në mënyrë proporcionale. Mund të merrë. Por.Të marrë është tjetër gjë. Në këto 12 vjet ne kemi parë që... Ma dëgjo, të lutem, që të ndodhë kjo, kjo duhet të jetë e shprehur në ligj. Po. Se s'mund të lihet në kompetencë të një drejtuesi, të një... po të jetë në ligj që thuhet në qoftë se, këtë kemi kërkuar dhe ne në qoftë se do ndodhë, se unë i qëndroj asaj, që buxhetet e bashkive dhe të qyteteve duhet të jenë në mënyrë proporcionale. Ne proporcionale e duam, nuk duam të marrim njësoj si Korça. Po në qoftë se ne kemi 30. 000 banorë, ata kanë 70. 000 banorë, ne duhet të marrim një të tretën dhe të jetë pjesë e investimeve që komuniteti, njerëzit i kërkojnë.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Marsel Selimas: Kryetar, kjo është diçka që ju takon juve. Neve si qytetarë këto gjëra nuk i dimë dhe nuk do t'i mësojmë kurrë. Thjesht na thoni dhe çfarë dëgjojmë. Por me ç'kemi parë, kemi parë që deri në 2014-n, kur është bërë bashkia e madhe, nuk kanë qenë këto investime. Që këtej e tutje investimet kanë qenë më të mëdhaja, apo jo? Është e dukshme, është e qartë. Plus asaj, dhe qyteti i Maliqit kishte një ndryshe, një emër, një diçka si në aspektin e reklamimit e të gjithave që të vinin njerëz dhe çdo gjë. Nëse do thonë Korça, është Korça, nuk do thonë Maliqi. Për qytetin e Maliqit kjo është një humbje. Është humbje e dinjitetit, është humbje e qytetit, është e të gjithave. Unë në veten time dua të flas vetëm në.Ajo është një reklamë e mirë për qytetin. Qoftë e keqe, qoftë e mirë, që ndodh dëgjohet emri i qytetit, dëgjohen të gjitha. Nëse nuk do ashtu do thonë Korçë, nuk do jetë ajo. Dhe unë besoj në veten time që nuk do marrim të njëjtat shërbime. Unë në veten time atë besoj. Nuk do kemi, duke filluar që nga pastrimi, që jemi një shembull, që nga këto të gjitha dhe nuk do jenë të njëjta. Unë këtë e besoj me 100% të vetes time. Unë personalisht, nuk e di dhe të tjerët. Di të them edhe këtë, unë po flas edhe në aspektin e sportit ose të këtyre. Besoj se nëse ndodh kjo të bashkimi, nuk besoj se do jenë dy fonde për të qenë dy ekipe ose dy ashtuja. Do humbasë kultura, do humbasin të gjitha. Unë e besoj këtë gjë.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Marsel Selimas: Po të të shpjegoj diçka. Po ka disa elementë që mund të bëhen më mirë. Unë mund ta them, mund të jetë kultura, mund të jetë sporti, mund të jenë aktivitete të cilat Korça i ka më mirë se ne. Normale që i ka më mirë se neve. Jo, ma dëgjo, do ma dëgjosh. Kultura në Korçë, teatri i kulturës që ata kanë, zhvillon aktivitete e tashmë që ne shyqyr që po bëjmë dhe pallatin e kulturës. Shyqyr. Patjetër ato aktivitete që do zhvillojnë atje do zhvillojnë dhe në ne. Këto janë elementë, por kjo nuk heq asgjë nga ato që mua më vjen mirë kur

ju vlerësoni punën që ne kemi bërë deri tani, mo, dhe kjo është pozitive. Ajo s'ka të bëjë me as çfarë duket, është e dukshme. Edhe diçka tjetër dua të them në sektin politik që the që ashtu.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Marsel Selimas: Unë di të them edhe këtë që jo gjithmonë subjektet politike bëjnë, marrin gjithmonë vendimet më të mira për qytetarët. Kanë edhe gabime. Dhe unë besoj se kjo është një nga gabimet më të mëdhaja që i bëhet qytetit të Maliqit, të paktën. Unë kështu e mendoj. Kështu e mendoj unë personalisht, jo të tjerët, edhe nuk është gabim që t'ia themi që këtu është gabim. Nuk është vetëm vetëm ajo. Ju faleminderit.

Përfaqësues i biznesit i qytetit të Maliqit;z.Ndiçim Vila: Tani, si qytetar, si banor dhe i përfaqësues i një prej bizneseve, edhe unë dua ta shpreh mendimin tim shkurt. Jam totalisht kundër, kundër shkrirjes. Nuk besoj se do ketë ndonjë gjë të mirë për qytetarët. Shumë mirë është kështu. **Përfaqësues i biznesit i qytetit të Maliqit;znj.Fatime Moharem:**Dhe unë, dhe unë si qytetare jam kundër shkrirjes dhe jam shumë dakort me djalin parafolës. Nuk dua të jap argumente më shumë se djali. E falenderoj djalin për mënyrën si foli dhe për argumentat që dha. Kaq.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Ridvan Zholanji:E dëgjuam me vëmendje. Kryetarin ekëshillit bashkiak, po ashtu edhe kryetarin e bashkisë. Po unë jam kundër kësaj shkrirje të bashkisë. Është bashkia e 12-të, renditet në rang republike edhe mbeten bashki me 3. 000 e me 5. 000 e me 10. 000 banorë. Kjo është fatkeqësi. Po me sa duket ata atje lart bashkinë e Maliqit e kanë shikuar si ambar votash. Nuk e kanë shikuar me prioritet. Juve thatë që do jetë më mirë kultura, sporti. Tani klub futboll, po Poajni do jetë më mirë apo klub futboll Maliqi? Nuk besoj se sytë i ka te Skënderbeu, nuk i ka te Maliqi. Edhe me pallatin e kulturës ka nevojë për reformim, ka nevojë të vjen lëvizje, po jo të varen nga Korça. Se bie fjala tani po bëhet tani, ka filluar po bëhet takim brezash nëpër fshatra. Përse mos të merr orkestra e pallatit të kulturës Maliqit po të vetëfinancojnë fshatarët kur orkestra mbahet me taksat e banorëve të bashkisë? Edhe kjo sallë këtu duhet të ishte plotë. Po me sa shoh unë është një administratë e trembur. Kjo vjen për shkak se ndoshta nuk kanë ardhur sipas meritokracisë. Ka ardhur koha të bëhet reformim në administratë, të vijnë sipas meritokracisë e mos kenë frikë as nga PS-ja as nga PD-ja se i heqin nga puna.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu:Të të shpjegoj, ky nuk është takim me administratën. Që të kuptosh. Jo, jo, jo. Ky është një takim me qytetarë, me qytetarë të cilët shprehin mendime pro ose kundra këtij projekti.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Ridvan Zholanji: Unë jam kundra. A kjo është gjë tjetër. Shkrirjes së kësaj bashkie se nuk do ketë më shërbime. Ai kryetari i bashkisë të Korçës nuk do t'i hapi më telefonin atij të administratës. Jo t'i hapi një punëtori, qytetari të thjeshtë. Për një problem, për një gjë zgjidhet këtu.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu: Mund të të shpjegoj diçka. Administrata nuk ka lidhje, nuk as pro as kundra. Administrata është në punë. Tani po të dalë administrata thonë dalin për veten e tyre. Po mos dali, pse s'doli? Tani kjo është. Jo, ma dëgjo mua, ma dëgjo mua se e ke të sinqertë këtë që po të them. Ky është një takim që këshilli i bashkisë, as unë jo. Po unë kam ardhur pasi nuk kam shkuar në dëgjesat e tjera në NJ.A administrative. Këtu kam ardhur në pozicionin e administratorit të qytetit se Maliqi nuk ka një administrator siç kanë institucionet e tjera, por varet

nga kryetari i bashkisë. Ndaj kam ardhur këtu pasi unë ligjërisht, ky është materiali, ky është materiali prej 20 fletësh të cilën unë e kam përgatitur për t'ia çuar Kuvendit të Shqipërisë me disa nga ato ide që ju thashë ju pak më parë, por të shtjelluar, të shtjelluar të gjitha çfarë ne kemi bërë në 12 vjet dhe për të thënë që bashkia ka performuar mirë në konceptin tim varet si shikohet. Më vjen mirë kur edhe opozita e shikon pozitivisht. E thashë pak më lart se ky është një vlerësim. Pastaj për të fituar kredo politike njëra anë apo nga ana tjetër kjo është gjë pastaj që unë mendoj nuk është vendi i këtij takimi.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari: Edhe diçka, ju lutem, më falni. Sot kjo sallë është e mbushur si asnjëherë nëpër takime të tjera me qytetarë, me banorë, me grupe interesi, me biznese dhe është më mirë kështu sepse vlen më shumë mendimi i qytetarëve sesa i administratës apo. .. Kështu që jemi më mirë kështu. Kush e do fjalën tjetër?

Përfaqësues i biznesit i qytetit të Maliqit;z.Nada Margo: Unë e dhashë atë ditë që dolëm në protestë. Jo, unë e kam zënë e lartë. Mendimin tim e dhashë atë ditë që ishim në protestë. Nuk jam dakort për shkrirjen e bashkisë për shumë arsye, po zgjidhur nga qytetarët e Maliqit për t'i mbrojtur interesat e tyre, jo për të firmosur ç'duken e bashkisë që i përfaqëson. Bota juaj sot do të mbahet mend me vite me radhë. Nesër kur qytetarët t'ju pyesin çfarë bëtë për Maliqin, secili prej jush do të duhet t'u përgjigjet duke i parë në sy. Ju jeni zgjedhur për të mbyllur për të mbyllur bashkinë e Maliqit. Ju jeni zgjedhur për ta mbrojtur atë, vota juaj sot do të jetë pjesë e historisë së këtij qyteti. Një votim zgjat disa sekonda, por pasojat zgjatin me breza. Mos u bëni brezi që firmosi zhdukjen e asaj bashkie.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Agim Luzi:S'dua të përsërit këto që thanë parafolësit, por po them si fillim kam këtë që jam kundër shkrirjes së bashkisë edhe s'kam pse them argumentat që thanë të tjerët. Po dua të them edhe këtë. Ai personi, deputeti që e quajmë, nuk duhet të ishte në këtë dëgjesë këtu. Gjoja na përfaqëson ai apo jo? Se ai e çon zëri natje.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu: Shiko, unë do të sqaroj situatën time që Maliqi nuk ka qenë i përfshirë në momentin që bashkia do të bashkohet me Korçë. Deri në momentin e fundit Maliqi ka qenë më vete dhe është deklaruar, është deklaruar që Maliqi do të ngelet dhe ne s'kemi pse e fshehim këtë punë. Në momentin e fundit rakordimet e shifrave të vizionit nuk e di ka arritur në këtë pikë dhe nuk ka lidhje, s'është marrë. Ai ka qenë një komision që s'ka të bëjë me deputetët. Deputetët duhet të shprehen kur të vijë momenti.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Agim Luzi: Do ishte mirë që ta dëgjonte zërin e qytetarëve. Ai na përfaqëson ne.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu: Po dakord. Ligji parashikon këto dy institucione të cilat duhet të shprehen për çdo reformë. Këshilli i bashkisë që duhet të marrë një vendim dhe këshilli edhe kryetari i bashkisë duhet të shprehet me një mendim, me një shkresë për këtë çfarë vjen. E parashikon kushtetuta edhe ligji të cilët na detyron ne të shprehemi. Këshilli bën dhe këto dëgjesa se e ka detyrim që të marrë mendimin e qytetarëve. Kështu është e parashikuar.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Benereta Pashollari:Përshëndetje. Unë jam rritur, lindur këtu në Maliq dhe nuk mund ta zgjas shumë. Jam kundra shkrirjes së Maliqit të bashkisë. Mirë, po kjo nuk quhet bashki. Duhet e Maliqit do shkrihet. Nuk po them shkrihet bashkia. Neve na kanë lënë prindërit me një edukatë shumë të mirë. Ama të gjithë jetën nuk na futën në punë se na anë te Korça. Korça këtu e Korça atje e Korça kudo dhe ne kemi qenë tërë jetën pa punë këtu. Pse vini nga tashi për brezat që do lëmë? A do kenë mundësi që të hyjnë në punë për fëmijë që do lindin? Qysh kjo është njëherë? Unë jam kundra, kundra, kundra. Kaq kisha. Faleminderit dhe ngrijeni zërin sa më shumë popull se do digjet Maliqi. Jo se do kemi gjëra të tjera. Faleminderit.

Banor i qyteti të Maliqit;Edhe unë këtë mendim kam e kam dhënë mendimin edhe atë ditë që ishin në terr gazetarët edhe sot po e jap këtë mendim. Bashkia e Maliqit nuk duhet të shpërbëhet. Dakord. Nuk jam të shkrihet bashkia e Maliqit.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu: Po ka një njësi administrative që e ndjen më shumë këtë punë dhe e ka më shumë është Maliqi. Po se për shembull ne ishim në Fojan ose ishim në Fojanë thonë Pojan pati edhe pro edhe kundra se ata e kanë lidhjen direkte më shumë me Korçën sesa me Maliqin. Domethënë kjo është thikë me dy presa të themi pasi edhe në bashkë edhe në njësi të tjera administrative edhe pse atë çfarë unë thashë në fillim nuk heq asnjë presje që s'ka krahasuar bashkia ose njësitë administrative sot me ish-komunat s'ka lidhje pasi atë e kanë shpjeguar që ne pothuajse në shumicën e fshatrave të fushës të paktën kemi asfaltuar në çdo fshat katër pesë gjashtë rrugë të cilat në ish-komunat s'flitshen dhe atë propozuesët propozuesët që kanë bërë aktin japin disa momente pse ata e shikojnë e shikojnë te reformat e thella të cilat për shembull t'u them një nocion që unë e kam propozuar në komisionin parlamentar ishte një propozim pasi ndodh që bashkitë e niveleve tona kanë disa funksione që nuk i bëjnë siç duhet. Plane strategjike edhe disa programe të cilat ndonjëherë projekte të Bashkimit Europian për mungesë kapacitetesh ndonjëherë dhe mungesë fondesh dhe propozimi ishte i imi ka qenë në komision parlamentar dhe është diskutuar gjatë pavarësisht se nuk u arrit se ndoshta kjo donte vendimmarrjen edhe votën edhe të opozitës se kërkonte ndryshime kushtetuese ishte kalimi me dy me dy nivele i administrimit të pushtetit vendor me nivel bashkie dhe nivel rajoni dhe rajoni të merrte disa kompetenca kur po them unë për Maliqin që disa edhe nuk i bën siç duhet llogarit bashki më të vogla e kanë edhe më të vështirë të cilët s'kanë specialistë kanë mungesë kapacitetesh burime njerëzore dhe ata patjetër që ishin në një farë mënyre të detyruar për t'u bashkuar por Maliqi duke qenë që ka afër Korçën ka afër Pogradecin edhe ka sjellë ka sjellë ndryshim edhe në edhe në administratë edhe në kapacitete njerëzore do të thotë që ne e arrijmë në masë të konsiderueshme performancën tonë pozitive dhe u mor si një propozim shumë pozitiv që të ishte me dy nivele në fakt në draft nuk figuron.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Festim Koçiu: Faleminderit unë jam unë jam unë jam kundër bashkisë bashkimit me bashkinë e Korçës se nuk mund ta quajmë për shembull shkrirje po e quajmë bashki për këto arsye që ka kaq vite që qyteti i Maliqit është në rang republike është qyteti më i pastër me i jo krime kështu që nuk ka e nuk ka ndatë për ujin për dritat është shumë qytet edhe na vjen shumë keq për shembull që në qoftë se neve do të bashkohemi me Korçën nuk do kemi këto shërbimet kurrë në kurrë ne po e shikojmë në pallatet në shkolla e mesme ka tre javë e hapur kanali për të sharë pusetat u ça e lanë vetëm sa bën ato vijat të kundërmon më fal era të kundërmon me një fjalë nesër kur nuk do kemi gjë në dorë neve nuk do na pyesë njeri fare për këto gjëra nuk do të kemi

as shërbime edhe besoj se edhe taksat për shembull që janë taksat vendore do të jenë më të larta siç paguhet në Korçë që sa çpaguhet uji paguhet dhe drita. Neve këtu paguajmë me kursim 5. 000 7. 000 lekë ujë. Atje në Korçë paguajnë 23, 24 ujë. Edhe fuqia e pagesës për neve nuk ne pensionista jemi jemi pa punë. Rini nuk ka. Kështu që do të jetë një ngarkesë shumë e madhe për ne. Edhe këtë do ta qajmë me lot. Do ta qajmë në qoftë se neve do bashkohemi me me Korçën dhe nuk do kemi as shërbime asgjë. Po shyqyr që jemi pensionistë edhe na duhet vetëm dhe marrim pensionin atje dhe nuk kemi se të jesh rini duhet të vesh për çdo gjë për shembull një ankesë në Korçë jo këtu. Neve shyqyr që e kemi bashkinë e na zgjidh çdo problem. Besoj se po u bashkuar nesër e tutje nuk do kemi këtë shërbim.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu:Të falenderoj. Unë unë ju dëgjoj me vëmendje edhe të njëjtat fjalë do thosha dhe vetë të isha në vendin tuaj por në pozicionin që kam jam i detyruar të shpjegoj atë çfarë projektakti sqaron por që nga e thënë të bërën të gjitha duhet bërë me akte ligjore dhe unë shqetësimet time e ngrita që nga shërbimet që nga funksionet që do të kryejë ky institucion qyteti të themi me një nocion tjetër që nga investimet që nga raportet e këshillit bashkiak në në me raport me këshillin e madh edhe tek shërbimet ndaj njerëzve. Pastaj vend ne kemi një material i cili i ka vajtur dhe këshillit më ka ardhur dhe mua nga bashkitë të forta. Është një projekt që financohet nga të huajt edhe ata marrin mendimet e tyre në lidhje me këtë pikë dhe ata hedhin disa konstatime të cilat janë shumë të rëndësishme. Një pyetje çfarë do të fitojë apo humbasë Maliqi nga integrimi me një bashki ekonomikisht dhe financiarisht më të fuqishme? Se kështu shikojmë konceptin ju lutem se ajo çfarë hidhet në material thuhet atë që citova pak më parë por ka disa pika. Ekonomia e bashkisë së Korçës është më e fuqishme se Maliqit. Bashkimi i të dyjave mund të ndikojë pozitivisht për të fuqizuar edhe bashkinë e Maliqit. Një të lutem të lutem tani më dëgjoni që t'ja më dëgjoni që çfarë tregojnë treguesit dhe ju shpjegova pak më parë se ka dhe tregues ekonomik ka kapacitet urban për shembull kapaciteti urban infrastrukturor Maliqi e ka 49. 4 Korça e ka 88 se investime ka marrë më shumë ka qenë qendër qarku ka qenë qendër rrethi e tjerë e tjerë çfarë mund të fitojë Maliqi shtrohet një nga pyetjet akses ju lutem t'ja u lexoj t'ja u lexoj ndoshta s'hyn asnjëri se e kemi dëgjoni jam i detyruar t'ju sqaroj dhe të përgjigjem çdo pyetje që ju mund të keni ta marr një fjalën unë a

Këshilltare e Këshillit bashkiak Maliq:znj Pranvera Begolli: Jam kundër bashkimit me Korçën dhe si këshilltare e bashkisë po si vajzë e këtij qyteti atje për shumë arsye. E para ati Maznikut do t' them vetëm një gjë. Ka bërë dëgjesën në Korçë. Nuk e bëri dëgjesën nëpër bashkinë e Maliqit. Pra ne kërkoi vinim tre këshilltarë se si vinte mirë të vinte këtu. E dyta performanca e bashkisë së Maliqit është nga më të mirat. Është bashkia e 18 a e 14 për popullsinë por dhe e dyta për bujqësinë. Ne i themi fusha e Maliqit, toka e Maliqit, këneta e Maliqit. Nuk i themi këneta e Korçës. Kështu që ka ca gjëra që duhet t'i kuptonte. E panë drejtimin, menaxhimin, investimet që janë bërë, ndryshime që është bërë kjo bashki. A pyetën ndonjëherë t'i shikojnë, t'i marrin përpara se të mendojnë bashkimin me Korçën? Se vërtetë Korça, po Korça ka investimet e veta, Maliqi ka të vetat. A e ndjen këtë ndryshim që nga 2014 deri tani? A kanë shkelur me radhë ai Masniku i pa çfarë ndryshime janë bërë në bashkinë tonë në të gjitha performancën e kësaj bashkie që kërkon të na bashkojë ne me Korçën? Unë jam kundra totalisht për këtë punë. I mbështes dhe ato rregulla që duhet të bëjnë patjetër, por ama ama dhe ligji i parlamentit të na tregojë për çfarë arsye bëhet ky bashkim, për çfarë arsye bashkohen këto bashki. Këtë do desha. Jam kundra bashkimit me Korçën totalisht. Maliqit i humbet identiteti. Po ju them kur është ndarë me ligjin 7501 Maliqi mbeti fshat

pa tokë. Mori libonikun lart nga kodrat. Mori fshat Maliqi. Këtej ne mbetëm për ibret. Do ikin të rinjtë. Do mbeten vetëm pensionistat. Kaq.

Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu:T'ju t'ju t'ju sqaroj një moment se është shumë i rëndësishëm. Në material në asnjë vend nuk thuhet që bashkia Maliq nuk ka performancë të mirë që dua ta saktësojmë këtë punë.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari: Zoti Islam ju lutem ju lutem ta dëgjojmë islamin

Banor i qyteti të Maliqit;z.Islam Kondi:unë që në fillim fare dua të them shpreh mendimin tim jam kundra bashkimit me Korçën unë jam banor i këtij qyteti prej 61 vjetësh e kemi mbaruar si shtet të asaj kohe komiteti ekzekutiv i rrethit të Korçës edhe po rikthehet prapë në bashkinë e Korçës. Jo për të bërë qejfin e për të thënë një të vërtetë të madhe që këto fonde i ka pasur bashkia e Maliqit. Ka bërë një këllëk të madh. Po të hesht sot qyteti i Maliqit ka marrë një pamje tamam qytet dhe kjo është merita juaj o kryetar edhe e Nildit këshillit bashkiak. Shikojmë Maliq qytet shikojmë Maliqin qytet bjerë qytet. Që nga institucionet komplet çfarë ku jam shikojmë fshatrat meqë s'kemi shkuar rrëmbecin pojanin nizaveçin podgorien institucione kulturore gjithandej ë mjekësia. Ambulanca në çdo fshat ka shkuar arsimi po ashtu shkolla janë ndërtuar nga e para janë ndërtuar shkollat si në rrëmbece në pojane kudo flas dhe për fushën ato që mbulojmë ne si organizatat e telanëve dhe pasardhësve shikojmë lapidare që gjithandej Plasa, Pojani, Rrëmbeci Lozhani podgoria që nesër s'ka për t'i bërë jam skeptik korça s'ka për t'i bërë asnjëherë asnjëherë prandaj unë jam kundra bashkimit me Korçën sepse nesër do të ndodhi kjo jam skeptik pra do i thoni ju kryetar që do ndihmohet nga Korça me të ardhurat që ka Korça Maliqi s'ka për t'u bërë asnjëherë kjo s'ka për t'u bërë asnjëherë asnjëherë s'ka për t'u bërë do na i mbledhin dhe e dyta e dyta kur vjen puna për të takuar hallet dhe problemet e qytetarëve me ju ne takohemi çdo ditë dhe një telefonatë na prisni në zyrë na qani hallit dhe problemet shkon në Korçë kryetari i bashkisë së Korçës nesër është e pamundur nuk të pret absolutisht jo atëherë shpresim ne këtë bashkim e takon dhe presim ne këtim ne kemi si familje prandaj edhe njëherë shpreh mendimin tim që jam kundra bashkimit me Korçë të bëj një pyetje sa shtëpi kemi financuar ne faleminderit

Këshilltare e Këshillit bashkiak Maliq:znj Pranvera Begolli: Sa shtëpi kemi financuar ne për të bërë çatitë? Një vajzë teze kam në Dishnicë nuk po i bëhet çatia.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Emijano Kodra: Kryetar të jemi krenarë që kemi bashkinë me performancën më të mirë. Këtë e them sepse në të gjitha trajnimet që bëjmë na thonë jeni model. E para. E dyta, investimet që keni bërë në këtë bashki janë kolosale dhe i ka rritur vlerën qytetit. Në qoftë se një shtëpi dikur shitej 1. 2 apo 1. 3 milion, sot një hyrje në pallat shitet 2. 8 apo 3. 4 milion lekë dhe kjo është falë statusit bashki, është falë ë asaj pune kolosale që ju keni bërë dhe shkrirja apo bashkimi, më fal, bashkimi i bashkisë Maliq me Korçën do rrëzojë të gjithë atë punë prej 12 vitesh. Faleminderit.

Banor i qyteti të Maliqit;z.Pëllumbesha Osmanllari:E fundit një grua haj po e fundit dhe e fundit të jetë për të gjithë Maliqin e përfaqësoj bilem edhe për fëmijët e vegjël mund ta jepnin këtë opinion pavarësisht se s'janë këtu. Maliqi asnjëherë të mos shpërbëhet, të mos bashkohet me Korçën, po të jetë zot në shtëpinë e vet.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari: Shumë faleminderit.Kjo ishte dëgjesa.Ditë të mbarë.

Mbajtës Protokolli!

Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

SEKRETARI I KËSHILLIT

Datë 13.08.2026

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 13.08.2026, në konsultimin Publik, në ambjentet e NJ.A Pojan Projektligji: "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë.
ora 13:00.

Të pranishëm:Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari, Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi; Këshilltarët:Fevri Sherifi; z.Andonaq Risto; Nersida Shindo; Kristina Malelli; Sekretari i Këshillit:Gertjan Gjiriti; Adminitratorja e NJ.A Pojan z.Kreshnik Azo; Kryetarë fshatrash; banorë të NJ.A Pojan sipas listës bashkangjitur.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari:Mirë. Mirëdita të gjithëve dhe faleminderit që jeni bërë pjesë e këtij takimi. Ky është një takim dëgjesë publike, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".Ku bashkia Maliq propozohet të bashkohet me bashkinë Korçë. Maliqi propozohet për t'u bashkuar për të fuqizuar kapacitetet financiare, për të fuqizuar kapacitetet tek burimet njerëzore, dhe duke u favorizuar nga afërsia me Korçën.Po ju them disa nga avantazhet dhe disavantazhet e kësaj reforme që mund të kenë banorët e bashkisë Maliq.

Për komunitetin e Maliqit pyetja është më konkrete:

Çfarë do të fitojë ose humbasë Maliqi nga integrimi me një bashki ekonomikisht dhe financiarisht më të fuqishme?

Konsultimi duhet të fokusohet në:

- financimin e shërbimeve;
- investimet në territor;
- punësimin dhe ekonominë lokale;
- zhvillimin rural dhe bujqësor;
- aksesin në shërbimet publike;
- ruajtjen e identitetit dhe rolit të komunitetit të Maliqit.

Bashkia Maliq ka aktualisht të publikuara konsultime për PBA 2026–2028, planin e menaxhimit të mbetjeve, planin social, arsimin dhe dokumente të tjera strategjike, çka tregon se konsultimi

mund të strukturohet mbi nevojat konkrete të komunitetit dhe jo vetëm mbi çështjen administrative të bashkimit.

2. Çfarë tregojnë treguesit për Maliqin?

Treguesi	Maliq	Korçë	Diferenca
IFB – kapaciteti financiar	49,7	70,2	-20,5
IPE – performanca ekonomike	26,2	55,2	-29,0
IMU – kapaciteti urban/infrastrukturor	49,4	88,6	-39,2

Treguesi më problematik është IPE 26,2.

Pra, dobësia e Maliqit është kryesisht **ekonomike**, ndërsa jo domosdoshmërisht një dobësi e plotë në të gjitha dimensionet.

Ky është një element shumë i rëndësishëm për konsultimin:

Maliqi nuk duhet të paraqitet si një bashki që nuk mund të funksionojë, por si një bashki me kapacitet ekonomik dukshëm më të kufizuar dhe që mund të përfitojë nga lidhja me një qendër më të fuqishme ekonomike.

3. Çfarë mund të fitojë Maliqi?

Mundësia kryesore është aksesimi i kapacitetit të Korçës.

Kjo mund të nënkuptojë:

- akses më të madh në investime;
- përmirësim të infrastrukturës;
- shërbime më të specializuara;
- akses më të mirë në tregun e punës;
- lidhje më të forta me bizneset e Korçës;
- mundësi për zhvillimin e bujqësisë dhe agropërpunimit;
- projekte të përbashkëta për turizëm, bujqësi dhe mjedis;
- kapacitet më të madh për përfitimin e fondeve të zhvillimit.

Në këtë kuptim, afërsia Korçë–Maliq është një avantazh i rëndësishëm, sepse integrimi ekonomik dhe funksional mund të jetë relativisht i lehtë.

4. Çfarë rrezikon Maliqi?

Kjo është pjesa që duhet diskutuar më hapur me komunitetin.

Rreziku kryesor është periferizimi i Maliqit.

Komuniteti mund të shqetësohet se:

- investimet do të përqendrohen në Korçë;
- shërbimet do të centralizohen në Korçë;
- qyteti i Maliqit do të humbasë funksionet administrative;
- zonat rurale mund të marrin më pak vëmendje;
- punësimi në administratën lokale mund të reduktohet;
- identiteti dhe roli i Maliqit mund të dobësohen.

Prandaj, çdo model konsolidimi duhet të shoqërohet me pyetjen:

Si garantohen shërbimet dhe investimet për komunitetin e Maliqit pas konsolidimit?

5. Çfarë duhet të kërkojë komuniteti i Maliqit?

Konsultimi mund të fokusohet në identifikimin e garancive konkrete.

Komuniteti mund të diskutojë:

1. A duhet të ruhet Maliqi si qendër lokale e shërbimeve?
2. Cilat shërbime duhet të vazhdojnë të ofrohen në Maliq?
3. Cilat investime janë më urgjente?
4. Si duhet të mbrohet potenciali bujqësor i zonës?
5. Si mund të lidhet prodhimi bujqësor i Maliqit me tregun e Korçës?
6. Si mund të sigurohet që konsolidimi të mos sjellë vetëm centralizim, por zhvillim ekonomik lokal?
7. Cilat janë kushtet që komuniteti do ta konsideronte një konsolidim të pranueshëm?

Mesazhi për komunitetin e Maliqit

Çështja nuk është vetëm nëse Maliqi duhet të bashkohet me Korçën, por çfarë modeli konsolidimi do të sigurojë që potenciali ekonomik dhe territorial i Maliqit të shndërrohet në investime, punësim dhe shërbime më të mira për komunitetin.ta bërë konsultimin të krahasueshëm, do të rekomandoja që në fund të dy takimeve të përdoret e njëjta pyetje:Nëse Korçë–Maliq do të konsolidoheshin, cilat do të ishin tre përfitimet kryesore dhe tre rreziqet kryesore që duhet të merren parasysh? Dhe veçanërisht të kërkohet nga pjesëmarrësit të vlerësojnë pesë fusha:

Fusha	Korçë	Maliq
Financat dhe buxheti	A sjell më shumë të ardhura apo kosto?	A sjell më shumë kapacitet financiar?
Investimet	A rritet potenciali për investime?	A rriten investimet në territor?

Fusha	Korçë	Maliq
Punësimi dhe biznesi	A zgjerohet tregu ekonomik?	A krijohen më shumë mundësi punësimi?
Shërbimet publike	A ruhen standardet aktuale?	A përmirësohen shërbimet?
Identiteti dhe përfaqësimi	A forcohet roli i Korçës?	A ruhet roli dhe identiteti i Maliqit?

Përfundim për procesin e konsultimit

Në këtë mënyrë, takimi në Korçë duhet të fokusohet te pyetja "çfarë përfiton Korça dhe sa kushton zgjerimi?", ndërsa takimi në Maliq te pyetja "çfarë përfiton Maliqi dhe çfarë duhet të garantohet që të mos humbasë?"Kjo e bën konsultimin më neutral dhe më të besueshëm, sepse nuk e paraqet konsolidimin si një rezultat të paracaktuar, por i jep komunitetit mundësinë të vlerësojë përfitimet, kostot dhe kushtet e nevojshme për një konsolidim të suksesshëm.

Nën/Kryetari i Këshillit:z.Faslli Zholi;Unë këtu njëherë ju keni këtu, dhe nëpërmjet jush edhe ata që nuk kanë patur mundësinë. Besoj se edhe ju do jeni dakord me mua: jam shumë i pakënaqur me pjesëmarrjen, me dëgjesat, me çdo dëgjesa kur vjen radha e çdo individi, çdo familjari, çdo qytetari që jeton në këtë vend të mos pyetet dhe të mos dëgjohet, dhe të mos japin mendime. Kjo këtu është edhe libonikë sot, dhe pjesëmarrja është shumë e ulët. Këtë unë nuk e kuptoj, sepse kaq... dhe nuk më vjen mirë që neve të jemi kaq poshtë për sa i përket këtij problemi, këtij halli që kanë qytetarët për mua. Tashi, Nidli, kryetari i këshillit e dha atë: atë janë seriozitë dhe të mirat që ka bashkia kur të bashkohet me Korçën. Unë po e nis: unë punoj në Korçë, në një firmë private. Nuk kam asgjë me Korçën. Përkundrazi, kam shumë miq në Korçë. Por që të shkojë bashkia e Maliqit, Pojani, e të gjithë njësitë administrative që i dini ju mirë se mua, të shkojë për një vërtetim, për një certifikatë, kur ne kemi zona të thella, ne kemi halle dhe probleme, dhe bashkia nuk është institucion ndërmarrjeje: prodhoj dhe falimentoj dhe e mbyll. Është një institucion që i jep shërbim çdo qytetari, në çdo kohë dhe në çdo moment, në çdo periudhë. Këtë duhet bërë pyetja: është e thjeshtë. Këtë alternativë që shtron qeveria, ka bërë projektin e cili nuk është miratuar, dhe shyqyr Zotit të mos miratohet, të mos ndodhi kjo, sepse do jetë dëm. Ne do të dëgjojmë edhe juve, se prandaj janë dëgjesat që janë: në qoftë se neve na bëhet mirë, hajde të bashkohemi, jo me Korçën pa ç'kemi ne në Elbasan. Le ta bëjmë projektin në Elbasan, ose në Tiranë, çfarëdo, të ngrihen çerdhet atje. Por unë mendoj se nuk është kështu. Bashkia tonë i ka të gjitha resurset, sepse është një bashki që ka mbi 31. 000 qytetarë. Janë sot... në qoftë se gaboj, janë 81 fshatra. Dhe unë jam për atë që të rrijë bashkia e Maliqit, se nuk kam asnjë interes si individ, apo si qytetar, apo si këshilltar. Jo. Nuk do bëhem as kryetar bashkie. Jam zëri juaj, jam me ju. Por e rëndësishme është që të mos e humbasim këtë shans. Ne të mos e lejojmë se çfarë thuhet nga lart do ta bëjmë nga poshtë. Sepse ne na preket interesi i qytetarit, jo i një individi. Sot është kryetar i X-it, nesër do bëhet tjetër. A ka mundësi? Ideja time është që të bëhet edhe një bashki këtu, një bashki këtu, në këtë godinë, në këtë popull. Po do të shkrijmë edhe atë qafë. Prandaj, unë ju bëj thirrje juve dhe kujtdo, që ta di: nuk dua të fut fare politikë, nuk marr pjesë fare për politikën. E kam thënë edhe kudo që unë deri tek hyrja e bashkisë kam mbajtur një subjekt politik, por aty jam munduar. A kam edhe unë të meta plot? A kemi të gjithë ne secilin plot? Jam munduar që të çoj zërin tuaj. Që

zëri tuaj të jetë ai që duhet. Dhe këtë po kërkoj. Dhe ju bëj thirrje ta mbrojmë këtë institucion të bashkisë, të mos e shpërdorojmë. Fare e thjeshtë është: po ta lëmë këtë godinë kaq të bukur që është bërë këtu, të ikim. Se do iki bashkia. Po iku bashkia, s'ka njerëz, s'ka shtëpia. Sado e mirë të jetë, po s'pati njerëz, do shkatërrohet. Trupi i investimit, trupi i kapacitetit. Dhe më shqetëson, sepse nuk është e thënë që edhe administrata të jetë këtu, zotëri, se kjo nuk është politikë e sotme. Dikush më tha atje që do ta bëjmë shkollë nesër në Vreshta. Ta bësh, nuk është politikë. Fëmijët tanë mësojnë atje. Këtë s'ka vend. Në Vreshta s'po e them. Kështu që të mos i politizojmë gjërat. Ka ardhur koha që t'i themi: kur na preket interesi, mos pyesim, po të pyesim për familjet, për fëmijët tanë. Ky është mendimi im. Dhe unë, edhe njëherë, që mos u zgjat të lë edhe juve të flisni, dua që bashkia të qëndrojë kështu siç është. Dhe a ka mundësi, po them, le të hapet bashkia tjetër këtu në Elbasan?

Banor i NJ.A Pojan: Jam Edlira, nga Maliqi, dhe martuar këtu. Po jam vendalie maliqare, dhe nuk dua që bashkia e Maliqit të prishet, sepse ajo ka qenë dhe le të jetë. Pse? Tani neve kemi një hall, një gjë: ku do veni, ku do qani? Në Korçë? Do na presë Korça neve? Kurrë. Një e njëjtë kjo. E dyta, administrata e këtu, ne na ka shërbyer për çdo gjë. Tashi, pse duhet të ikim? Pse duhet të ikim? Mirë unë, po ata mosha e tretë, ku do venë? He, ku do na çojnë? Për një kartë, për një firmë, për një gjë, ku do ankohemi? Ku do venë fëmijët tanë pastaj? Po u mbyllën këto? Ikën fëmijët. U zhduk. U zhduk Maliqi, u zhduk këtë. Ku do venë? Këtë të mendoni.

Banor i NJ.A Pojan:Përshëndetje. Unë, pensionist jam. Që të ngrihem unë. Tani çështja mbi Po ka edhe mosha të reja, për një lindje, pleqëri, lindje, po një vdekje, të ngrihen, të vijnë në Korçë apo të vijnë të gjithë, të gjithë. Gjendja civile me tërë këtë popullatë që ka administratë dhe po janë, nuk duhet të largohen. Këtë vendim i themi qeverisë. Dhe qeveria ta mendojë mirë, se gjithë pensionistët e vendit që ka, ta dinë se do mbeten të pakënaqur. Kaq i themi qeverisë. Faleminderit. Kaq.

Kryetar i fshatit Zvezdë NJ.A Pojan z.Adriatik Lilo: E bën atë që do. Jo, kaq. Kjo është fakt i bërë. Zvezda ka tërë beahrin, pa ujë. Pa ujë. Kjo është e bën e gjitha. Tarja po na sjell në vërdallë: si pushtetin lokal këtu, edhe qeverinë, edhe të tjerët. Do të marrë ujë Tarja nga ujë Shkupi, apo nga bër? Ne kemi të pushtetshmëri. Ç'po bëjmë me këta ujë, sa duhet? Ç'po bëjmë pa marrë ujë nga bër? Kaq. Ja, ky është pushteti i qeverisë apo i korçës. Pse zgjat me andej? Ne e kemi fakt të kryer tani, s'po e bëjmë dot. Një tare po sjell vërdallë një qeveri.

Banor i NJ.A Pojan:Përshëndetje.Është një mesazh i vogël, kjo se ne nuk e kemi ta vendosim këtë. Po ta bëj gabimin më të madh se s'na ka pyetur ne më përpara. Duhet të na pyesë edhe ne më përpara, se qeveria kemi zgjedhur ne, si popull. Edhe të dytën, qeveria. Se neve këtu e kemi pasur administratën, kemi pasur edhe vendimin. E duam këtu. Pa diskutim. Është i vetëm problemi që gjithë ne kemi këtu, nuk bëjmë të rregullt në anë, sidomos në moshë e tretë. Edhe qeveria të dijë edhe këtë, se ne moshë e tretë po e mbajmë këtë pushtet.

Banor i NJ.A Pojan:Për reformën territoriale. Dua të dimë cilat janë mangësitë e Bashkisë Maliqit dhe cilat janë benefitet e Bashkisë Malit, sidomos fitimet, kontributet, puna, investimet e tjera. Lidhur me këtë, ne si banorë të njësisë administrative të Bashkisë Maliq, na ka ndodhur gjithmonë: një telefonatë me kryetarin, një sqarim, një problem, gjithmonë ka qenë i zgjidhshëm. Nesër nuk

dihet. Ne i kemi falënderuar të gjithë, pa patur dallime partiale, këto nuk na rrinë ne. Këtu do shikojmë interesin e përgjithshëm të popullit. Kështu që unë mendoj se, lidhur me investimet, mos na ndodhë "afër detit, afër mbarimit". Pra, për këtë them: të shikohet dhe të bëhen gjëra. Nuk janë investime territoriale, por të shikohet çfarë fonde mund t'i përkasin bashkisë, ish-bashkisë, ose qendrave administrative. Lidhur me këtë gjendje civile, do ta them përsëri.E keni shumë të prekshme, pra është shumë e ndjeshme.Është e prekshme dhe është e domosdoshme.Pse e hoqe?

Kryetar i fshatit Orman NJ.A Pojan z.Anastas Krekas: Mirë kështu siç jemi. Ose ishim më mirë kur ishim po më vete. Marrim shembull nga Greqisë: në Greqi vërtetë u bë kjo që po bëjmë ne, po ishte 2 fshatra ishin komuna, edhe u bashkuan me 4 dhe u bë si mini-bashki. Kurse këtu ne s'të vjen radha me kë të takosh në Korçë, kryetarin e bashkisë. Më mirë edhe ti thonë "ishte komiteti i partisë", tash i thonë "bashkia Korçë". Ti je vetëm një shembull, po jo në Lekas, se ka njerëz atje. Për 2 metra tub kanë ndenjur 1 muaj pa ujë. Na vjen radha neve nga Pojani, nga Zëmblaku, nga Moglica, nga Lozhani, të takojmë kryetarin. Rallë ndodh kjo. Shërbimet? Shërbimet ne s'i kemi? Të shkëlqyera, tash siç jemi. Jo t'i kemi kur të bëhen 160 fshatra. Kë do takojmë ne? Ku të jetojmë? Sot s'ka ujë konkretisht normal. Bie telefoni, s'ka rrjet fare. S'ka.

Banor i NJ.A Pojan: Përshëndetje.Dua të them vetëm një fjalë, një fjalë: kryetari i Kuvendit e tha, "Pojani nuk më intereson", por vetëm pesha politike do të thotë që kjo është politikë. Kryetari mendon që ne po i hedhim në punë disa gjëra të tjera nga pesha politike.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari:Po jo, jo, kurrë. Kurrë e ka thënë. S'e ka thënë. Nuk e ka thënë. E nuk e ka thënë këtë. Tani ai s'është këtu. Dakord, mirë, vazhdo.

Banor i NJ.A Pojan: Mbase kam unë keq informacionin.Pojani ekziston mundësi e rreptë se bashkimi bëhet. Në qoftë se sot e thotë Maliqi që nuk bëhet vonë për Zerecin dhe për Moglicën, Korçës nuk i bëhet vonë me qerre, as për Pojanin. Se Korça ka interesa të tjera nuk i bëhet vonë për Zerecin, për Moglicën, dhe as për Pojanin. Kështu që mendimi im është që bashkia të vazhdojë.

Kryetar i fshatit Pojan NJ.A Pojan z.Xhafer Gjyshllari: Mund të bëhet Pojani. Minibashki? Në qoftë se bëhet Pojani minibashki, ne kemi kritikë. Në qoftë se Pojani e hoq në punën e maliqit, asnjë gjë nuk pati fitim. Të tërë po shkojnë me nga 10. 000 lekë nga taksitë e të gjithëve, që shkojnë për shërbimet e maliqit. Nuk është problemi ky, se do ikë maliqi. Po janë në një takomë Korça. Me Korçën është më mirë dhe më afër. Autobuzat janë, linja është. 1. 000 do vejë, 1. 000 do kthejë, 2. 000. Po të bëjë maliq, do jap 10. 000 lekë. Edhe mirë është se shkrihet. Kaq.

Anëtarë i Këshillit z,Andonaq Rist Kështu e bëjmë çdo vit. Ne zonën tonë nuk na prek shumë.Ne nuk na prek shumë kjo largësia, se ne po t'i bie në... është më afër, kemi Korçën sesa kemi Maliqin. Dhe po të jetë për problematikat që thonë të gjithë paraforësit, nuk është se kemi ndonjë vend ku ne po zgjidhim hallet dhe problemet. Se ne po fillojmë me hallet dhe problemet këtu, nuk mbarojmë dot deri nesër në mëngjes. Kështu që nuk është ndonjë hall i madh ky për ne, se u bashkuam me Korçën apo se jemi në Maliq. Sepse ne deri sot nuk na është zgjidhur asnjë hall. Po të vish, tokat janë tharë fare për ujë. Ne vetëm diskutojmë dhe nuk kemi rrëshqitje të tjerë, di shumë mirë, dhe e kam rritur si problem: asnjë nuk zgjidhet, asnjë masë nuk merret. Dhe ne

thërrasim njerëzit sot, po sot nuk zgjidhet. Ajo zgjidhet me afatgjatë. Duhet menduar, duhet bërë një plan i mirë. Dhe, dhe ju e dini shumë mirë që tokat po thahen, të gjitha, nuk ka. .. ne të ardhmen e kemi nga toka. Nuk e kemi se u shkri Maliqi apo u shkri Korça. Unë këtë mendim kam.

Kryetari i Këshillit:z.Ornildi Demollari:Faleminderit! Kemi diçka tjetër? Ditë mbarë.

Mbajtës Protokolli!

Sekretari i Këshillit

Gertjan GJIRITI